

BEHGJET PACOLLI

TË LOBOSH

PËR

KOSOVËN

Pavarësia dhe SHBA-të

Vëllimi i parë - Përmbledhje e komentuar dokumentesh, komunikimesh, artikujsh



Redaktor: Mentor Nazarko

Dizajni: Rrota, www.rrota.com

Përmbledhje e komentuar dokumentash, komunikimesh, artikujsh

Foto në ballinë: Behgjet Pacolli dhe Henry Kissinger, ish sekretar amerikan i shtetit

Botues: Bota Shqiptare

Prishtinë, Qershor 2014 Copyright © Behgjet Pacolli

TABELA E PËRMBAJTJES

ANGAZHIMI I BEHGJETIT PËR KOSOVËN	9
PSE LOBOVA UNË PËR PAVARËSINË NË SHBA?	11
KALENDARI I FAKTEVE DHE QËNDRIMEVE NDËRKOMBËTARE, GJATË LOBIMIT TIM	20
BEHGJET ISA PACOLLI BIOGRAFIA	26
SI LINDI AKR?	30
KOMPANIA QË LOBOI PËR KOSOVËN	34
KURS I RI PËR KOSOVËN	37
KEN YATES: “UNIVERSITETI AMERIKAN I KOSOVËS, VATËR ELITARE E PROMOVIMIT TË LIDHJEVE ME SHBA”	43
KOMPANIA E PACOLLIT FAVORIZON KOSOVËN NË EURONEWS.....	45
ALEANCA PËR KOSOVËN E RE URË LIDHËSE ME NIVELET E LARTA TË POLITIKËS NDËRKOMBËTARE.....	47
CEREMONI E PAHARRUESHME E HAPJES SË AUK	49
INTERVISTAT POTENCIALE ME PERSONALITETET POLITIKE TË KOSOVËS	51
LISTA E BORDIT TË KËSHILLTARËVE TË ALEANCËS PËR KOSOVËN E RE	53
REALITETET E BALLKANIT	55
KOSOVA: RRUGA E SË ARDHMES?.....	67
PAVARËSIA E KOSOVËS DO TË VIJË NËSE SHQIPTARËT DO KËRKOJNË KOMPROMIS.....	69
KOSOVA: RRUGA PËRPARA?.....	71
MEMORANDUM NGA BORDI I UNIVERSITETIT AMERIKAN TË KOSOVËS.....	75
PACOLLI ËSHTË KU SËRBBIA KA NDIKIM TË KUFIZUAR	77
HOSKINSON I SHKRUAN PACOLLIT PËR TAKIMET E SHUMTA QË E PRESIN NË SHBA	79
MBËSHTETJE EDHE PËR GAZETARËT KOSOVARË.....	81
FTESË DREJTUAR PRESIDENTIT TË KOSOVËS, FATMIR SEJDIU	83
BEOGRADI KA PARANOJË PËR ROLIN E PACOLLIT NË KONFERENCËN MBI BASHKËPUNIMIN RAJONAL NË SHBA.....	85
MEMORANDUM DREJTUAR PACOLLIT MBI PLANIN E KONFERENCËS SË TETORIT 2006.....	89
LETRA FALENDERUESE PËR SHPENZIMET	92
KOSHTUNICA NË SHBA KUNDËR PAVARËSISË	93
SËRBBIA INVESTON 600 MIJË DOLLARË PËR LOBIMIN KUNDËR KOSOVËS.....	95

2 NGJARJE TË MËDHA NË VJESHTË.....	97
KONFIRMOVA PJESËMARRJEN NË KONFERENCË	99
AMERIKA: SHQETËSIME PREJ LDK-SË. AKR, VERSION REZERVË PËR QEVERISJE	101
LISTË SHPENZIMESH ME VLERËN 70 MIJË DOLLARË	102
AKR TAKOHET ME WISNER	103
KOSOVA E RE - KUSHTETUTA - MENDIME STRATEGJIKE	105
VIZITA E WISNER NË KOSOVË.....	107
KUJDES ME SIGURINË PERSONALE. GJËRA TË KËQIJA IU NDODHIN NJERËZVE TË MIRË	109
NEVOJA PËR TË LOBUAR ËSHTË RRRITUR.....	111
DISA ÇËSHTJE ME INTERES.....	113
PROPOZIMI I CSIS PËR KONFERENCËN MBI INTEGRIMIN RAJONAL EKONOMIK	115
KUNDËRSHTARËT E KOSOVËS SË RE DUHET TË NDALEN.....	117
ARTIKULL I BUGAJSKIT, NË “WALL STREET JOURNAL” RUSIA JASHTË VENDIT	121
KORRESPONDENCA ME KLINTON PËR TA FTUAR NË KOSOVË	125
KOSOVA SI PJESË E PROJEKTIMIT TË RUSISË.....	127
LETËR E CSIS DËRGUAR PACOLLIT PËR ZGJEDHJEN E TIJ SI ANËTAR I KËSHILLIT NDËRKOMBËTAR TË CSIS DHE PJESËMARRJE NË KONFERENCË	131
QENDRA PËR STUDIME STRATEGJIKE DHE NDËRKOMBËTARE.....	133
MEMORANDUMI “PRANVERË/VERË E TRAZUAR NË LINDJEN E MESME”	139
BASHKËBISEDIME ME CSIS.....	140
NJOFTIM I CSIS PËR KONFERENCËN E ALEANCËS PËR KOSOVËN E RE.....	149
E ARDHMJA E BALLKANIT DHE STABILITETI I KOSOVËS	151
HAPJA E NJË ZYRE TË AKR-SË NË PRISHTINË SHËNON NJË HAP TË RI NË PËRPPJEKJET TONA PËR TË PROMOVUAR PAVARËSINË.....	157
NE TANI E KEMI ARRITUR PIKËN KU PAVARËSIA ËSHTË E PRANUAR GJERËSISHT BRENDA AMERIKËS.....	159
NË KONGRESIN E SHTETEVE TË BASHKUARA KA DISA GRUPE TË PËRFAQËSUARA VOTUESISH ME LIDHJE TË FORTA ME ISH-JUGOSLLAVINË	161
DIMENSIONI EKONOMIK I PAVARËSISË	165
KONFERENCA: “INTEGRIMI EKONOMIK DHE MUNDËSITË E INVESTIMEVE NË EVROPËN JUGLINDORE”	167
NEVOJA PËR NJË “PLAN RAJONAL” QË LIDH INTEGRIMIN EKONOMIK RAJONAL ME MARRËVESHJEN PËR STATUSIN PËRFUNDIMTAR... ..	169

STATUSI DO TË JETË ÇËSHTJE DISKUTIMI NË DATËN 15 NËNTOR !.....	173
PROGRAMI I MEDIES.....	175
OBJEKTIVAT E KONFERENCËS: “BASHKËPUNIMI EKONOMIK DHE INVESTIMET, MUNDËSITË NË EVROPËN JUGLINDORE”	187
BULETINI: SHËNIMET E KOSOVËS DHE KOMENTE	189
KOSOVA: PROGRESI NË FUND.....	193
LAJMET E FUNDIT	195
PAVARËSI PËR KOSOVËN	197
BULETINI: SHËNIME DHE KOMENTE PËR KOSOVËN.....	199
“REALITETI MBIZOTËRUES ËSHTË QË KOSOVA DUHET TË JETË NJË VEND I PAVARUR”	201
MBËSHTETJA FINANCIARE PËR KRIJIMIN E AUK KA ARDHUR POTHUAJSE EKSKLUZIVISHT NGA POPULLI DHE INSTITUCIONET E KOSOVËS	203
ANEKS - ARTIKUJSH TË SHTYPIT TË SHKRUAR VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR RRETH VEPRIMTARISË TIME TË ASAJ PERIUDHE	204
INTERVISTA TË CILËS I PËRTYPËN SHUMË TITULLIN, POR KURRË PËRMBAJTJEN.....	212
PSE BEHGJET PACOLLI PAS VEPRAVE TË MËDHA, KA VENDOSUR TË KTHEHET NË VENDLINDJEN E VET? PASTHËNIE NGA EDI RAMA	236
NJË GUR KILOMETRIK THEMELTAR NË HISTORINË E DIPLOMACISË SË SHETËTIT TË RI TË KOSOVËS	238

BEHGJET'S COMMITMENT TO KOSOVA

Janusz Bugajski

I first met Behgjet Pacolli in Washington D.C. in October 2005 during one of his many visits to the U.S. capital to muster support for Kosova's independence. We had dinner with a group of prominent American supporters of Kosova organized by a consulting firm that Behgjet had recently hired. He wanted to get to know the Washington policy community and to launch a more systematic campaign for the birth of Europe's newest state. I was surprised at how low key and modest Behgjet proved to be, knowing full well that he was a high flyer in construction, well-connected around the world, and evidently very wealthy. He took part in our discussions over dinner but clearly was there to listen and not to impose his views.

First impressions proved correct as my suggestions for Behgjet to establish a closer relationship with my organization, the Center for Strategic and International Studies, were well received. He wanted to learn more about who we were and what we did and was eager to explore any avenue to push forward the process of Kosova's independence. At that time there was still pervasive doubt that Washington would follow through on the statehood question and the aspiring country seemed to be hanging in a political limbo.

I sensed that Behgjet had come to a point in his life where he wanted to give something back to his country and his people. This was not driven by the profit motive or by political ambition but by something much deeper, a love for his country of birth and for his bigger family of Kosovars. He could simply have stayed on the sidelines and continued to devote his energy to developing his business and making a fortune, but for Behgjet this was simply not enough at a time when his country needed him most.

Over the next two years, Behgjet developed a close relationship with CSIS. We organized international conferences on Kosova and the Balkan region in Washington and Prishtina which he sponsored and funded. Our aim was to demonstrate how important Kosova was for the wider region and that stability in the aspiring state would be better assured by recognizing its sovereignty and independence. We also developed Behgjet's idea that South East Europe would only become fully stable and secure through closer economic and business links between all of its capitals.

Behgjet's commitment to his country was also mirrored in his support for CSIS. He understood that the Center had influence in Washington policy circles and involved a number of prominent former officials in its programs. He was invited to join the CSIS International Councilors, a group of prominent businessmen chaired by former U.S. Secretary of State Henry Kissinger. Behgjet's first-hand global experience in developing the infrastructure of new states and emerging democracies was highly valued by the group.

I came to admire Behgjet's energy level and tireless work ethic. Not only was he running his business from Lugano and visiting his major construction projects in Kazakhstan, he also became a more frequent visitor to Washington and decided to become more directly involved in Kosovar politics. He was clearly frustrated that the existing parties and politicians were insufficiently active internationally in pushing for independence. He also felt that he could make a direct contribution to Kosova's transformation from a post-communist wasteland to a prosperous democracy. His business experience and his international contacts could be put to good use to rebuild his country and generate a sense of pride among his people. Behgjet's work continues and I am certain that he will become a vital part of Kosova's future just as he has been during its emergence as an independent state.

Washington D.C. March 2010

ANGAZHIMI I BEHGJETIT PËR KOSOVËN¹

NGA JANUSH BUGAJSKI

Takimi i parë me Behgjet Pacollin ka qenë në tetor 2005, në një nga vizitat e tij të shumta në Uashington D.C., për rritjen e mbështetjes për pavarësinë e Kosovës. Ne darkuam me mbështetësit më me ndikim të pavarësisë së Kosovës, darkë e organizuar nga një kompani lobuese që Behgjeti sapo e kishte kontraktuar. Ai dëshironte të njihej me komunitetin politik të Uashingtonit dhe të niste një fushatë më sistematike për lindjen e shtetit të ri në Evropë. U habita me modestinë që shfaqte, me vetëpërmbytjen, edhe pse ishte një ndërlyes i madh, me lidhje të rëndësishme në mbarë botën, dhe qartësisht shumë i pasur. Ai u bë pjesë e diskutimit tonë përgjatë darkës, duke preferuar të dëgjonte më shumë sesa të shprehte pikëpamjet e tij.



Bugajski, unë dhe drejtuesi i Qendrës për Studime Ndërkombëtare Strategjike, John Hamre

Përshtypjet e mia të para u vërtetuan, ndërsa ai mirëpriti sugjerimet e mia për të vendosur lidhje më të ngushta me organizatën time, me Qendrën tonë të Studimeve Ndërkombëtare Strategjike. Ai donte të dinte më shumë rreth nesh, çfarë bënim, dhe ishte plot entuziazëm për të eksploruar çdo rrugë që mund të çonte përpara procesin e pavarësisë së Kosovës. Në atë kohë ishte përhapur dyshimi nëse Uashingtoni do të vijonte a jo në drejtim të shtetësisë, dhe vendi aspirant i pavarësisë dukej se po varej nga një bllokim politik.

¹ Kur lexon këto fjalë të shkruara që në mars të 2010 nga Bugajski, ti ndihesh krenar pse dikush që ka një eksperiencë kaq të madhe ndërkombëtare shpreh vlerësim të lartë për patriotizmin tënd, i cili nuk është i tipit bërtitës, deklamativ, për konsum të brendshëm. Bash për këtë arsye ai nuk është dokumentuar aq sa duhet në mediet vendore, madje është dokumentuar fare pak. Jo thjesht për shkak të xhelozisë sonë politike tradicionale, por dhe për shkak të modestisë sime për të cilën flet Bugajski, plot të tjerë, mes të cilëve, krejt në fund, por jo më i parëndësishmi, është Edi Rama. Për këtë arsye ndihem i frustruar kur gjndem në mjedise politike të cilët mendojnë se mund të manipulojnë me goja ndjenjat patriotike të qytetarëve të Kosovës duke bërë referenca për lidhjet e mia të biznesit me Lindjen. Le të lexojnë këtë libër dhe të shohin lidhjet e mia me SHBA-në, miqësitë, nderimet akademike, titujt “Qytetar Nderi”, etj. Këta njerëz që bëjnë sikur e shohin Kosovën në qendër të botës, por në fakt atje kanë veten e tyre, do mund të kritikonin me të njëjtin pasion dhe Klintonin për marrëdhëniet e veta miqësore me udhëheqës të vendeve të Lindjes kur ishte President. Kjo ndjenjë frustrimi më kalon sakaq kur dal në ajrin e pastër jashtëpolitik, mes qytetarëve të Kosovës që më duan shumë, mes atyre të Shqipërisë, në kontakte me qarqet akademike të vendeve tona, të atyre të biznesit, që ma thonë jo pa mburrje se janë ndierë krenarë me emrin tim kurdoherë që kanë udhëtuar në botë.

E kuptova që Behgjeti kishte mbërritur në një pikë të jetës së vet në të cilën ai po interesohej për t'ia shpërblyer vendit dhe popullit të tij. Ai nuk ishte shtyrë nga motive përfitimi apo ambicie politike por nga diçka më e thellë, dashuria që kishte për vendin e tij të lindjes dhe familjen e madhe të kosovarëve. Ai mund të rrinte thjesht në anë dhe të përkushtonte energjitë e tij në zhvillimin e biznesit duke bërë shumë para, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për Behgjetin në një kohë kur vendi kishte aq shumë nevojë për të.

Për dy vjet mbajti lidhje të ngushtë me Qendrën për Studime Strategjike Ndërkombëtare (CSIS). Ne organizuam konferenca për Kosovën dhe Ballkanin në Prishtinë dhe në Uashington të cilat ai i financoi dhe i mbështeti. Qëllimi ynë ishte të tregonim se sa e rëndësishme ishte Kosova në mbarë rajonin dhe se stabiliteti në atë vend do të sigurohej më së miri nëpërmjet njohjes së sovranitetit dhe pavarësisë. Ne e zhvilluam idenë e Behgjetit se Evropa Juglindore do bëhej tërësisht e qëndrueshme dhe e sigurt nëpërmjet marrëdhënieve më të ngushta ekonomike dhe biznesore ndërmjet gjithë kapitaleve të veta.

Angazhimi i Behgjetit për vendin e tij, u pasqyrua dhe në mbështetjen e tij për CSIS. Ai e kuptoi sa e rëndësishme ishte Qendra jonë me influencën e saj në qarqet politike të Uashingtonit që përfshiu një numër ish-zyrtarësh të nivelit të lartë në programet e veta. Behgjetit iu bë ftesë të bëhej Këshilltar Ndërkombëtar, në një grup biznesmenësh të shquar, kryesuar nga ish-Sekretari Amerikan i Shtetit, Henry Kissinger. Eksperiencia globale e dorës së parë e Behgjetit në zhvillimin e infrastrukturës së shteteve të reja dhe demokracive të sapolindura, vlerësohej shumë nga grupi.

Unë zura të admiroj energjitë e Behgjetit dhe etikën e tij të palodhur të punës. Ai nuk interesohej vetëm për Luganon dhe Kazakistanin, ku kishte edhe projektet e biznesit të tij, por ai u bë një frekuentues i rregullt i Uashingtonit, dhe vendosi të përfshihej direkt në politikën kosovare. Ai ishte qartësisht i zhgënjyer ngase partitë ekzistuese dhe politikanët nuk ishin mjaftueshëm aktivë në planin ndërkombëtar për të nxitur pavarësinë. Ai, gjithashtu, e ndiente se mund të jepte një kontribut të drejtpërdrejtë për shndërrimin e Kosovës nga një djerrinë postkomuniste në një demokraci të begatshme. Eksperiencia në biznes dhe kontaktet e tij ndërkombëtare po përdorshin mirë për rindërtimin e vendit të tij dhe për të prodhuar ndjenjë krenarie tek populli i tij. Puna e Behgjetit vazhdon dhe unë jam i sigurt se ai do jetë pjesë vitale e të ardhmes së Kosovës gjatë lindjes si një shtet i pavarur.

Uashington D.C. Mars 2010

PSE LOBOVA UNË PËR PAVARËSINË NË SHBA?

NJË LIBËR PUNËSH DHE JO FJALËSH

Siç më ka thënë një burrështetas i madh kohët e fundit, unë nuk di të tregoj gjithmonë pjesë të rëndësishme dhe të jashtëzakonshme të jetës sime. I prekur nga e keqja njerëzore, apo nga modestia, i pushtuar nga punëra të mëdha, nga një listë e gjatë prioritetesh të qëndrueshme apo të ndryshueshme të vendosura në hapësirë, por që më lejojnë pak kohë të tregoj për veten, unë nuk kam bërë publike shpesh vepra të mëdha të miat në favor të kombit dhe popullit tim. E di që ky është gabim i madh, jo thjesht pse përfytyrimi publik rreth meje është i paplotë, por dhe pse historisë sonë do i mungonte kështu një copëz e vogël kontributi si ajo e imja.

Kësaj here mora një vendim tjetër. Krejt rastësisht pashë korrespondencat e mia me faktorë të rëndësishëm të diplomacisë amerikane në favor të shpalljes së pavarësisë pas ngjarjeve të vitit 2004, së bashku me shumë artikuj në shtypin amerikan dhe atë botëror, si dhe pak foto që e sjellin atë periudhë. Ishte një punë e madhe, vërtet, dhe bashkëpunëtorët e mi e kishin sistemuar bukur, aq sa mua, falë kujtesës sime të veçantë, më erdhi në mendje gjithë ajo periudhë e madhe angazhimesh që kulmoi me thënien e famshme të Presidentit Bush në Tiranë: **“Kosova duhet të jetë e pavarur: Tani!”** I mbushur me kujtime dhe emocione thashë: Unë dua t’ia bëj të ditur gjithë këtë punë popullit tim, rinisë sonë, studiuesve të diplomacisë! Në Kosovë, apo gjetkë!



Presidenti Bush së bashku me Presidentin Moisiu kalojnë në rivistë, Gardën e Nderit. Qershor 2007.

Kështu lindi ideja e këtij libri dokumentar i shartuar me kujtime apo shpjegime të kohës dhe hapësirës ku zhvillohen ngjarjet. Besoj se në këtë libër dokumentar (ku korrespondencat apo artikujt janë në origjinal në gjuhën angleze, në PDF), jepen dëshmi të pamohueshme të këtij kontributi të madh për të cilin unë jam krenar. Përbri secilës letër në PDF gjendet një sintezë e shkurtër apo përkthim i plotë në shqip dhe ndonjë përjetim imi. Ka një aneks me faksimile artikujsh të shtypit kosovar, kryesisht të asaj periudhe. Kështu vendosa ta paraqes përmbledhjen time të parë dokumentare rreth lobimit, përmbledhje e cila shoqërohet me fotografi.

Besoj se prej kësaj forme të zgjedhur për të prezantuar aktivitetin tim të madh lobues në SHBA, kuptohet qartë se çfarë kam bërë dhe çfarë pasojash ka sjellë vepra ime. **Në këtë libër, siç kuptohet, nuk ka shumë foto të kohës nga takimet e mia me personazhet që kanë lëvizur mbrapa apo para perdes së veprimtarisë diplomatike amerikane.**

As me protagonistët e mëdhenj që vunë firmën në aktet e rëndësishme, apo ata që unë i quaj arkitektët e pranimit të pavarësisë si zgjidhja e vetme për të ardhmen e Kosovës. Nuk ka, gjithashtu, as dhe shumë komunikime të miat, por janë kryesisht të tjerët që më njoftojnë mua për veprimtarinë e tyre, apo të zyrtarëve amerikanë të rangjeve të ndryshme të mobilizuar në favor të pavarësisë. Ka artikuj të ndryshëm në mediet më të rëndësishme të SHBA-ve dhe botës mbarë. Ka fjalime. Ka arsye serioze për këto mungesa fotosh apo komunikimesh. Unë s'jam përpjekur të bëj foto me këta miq të mëdhenj amerikanë, të cilëve po i shlyej një borxh mirënjohjeje për këtë që kanë bërë në favor të kombit tim. S'isha në politikë dhe si zakonisht unë s'jam përpjekur për dukjen. Ndërkohë, gjithë kjo punë e tyre ka mbraja idetë e mia fillestare, sugjerimet e mëpasme dhe forcën time lëvizëse ideore, infrastrukurore, financiare. Nuk ka kurrfarë dëshire për protagonizëm, por mendoj se historia do të flasë për këtë pjesë të diplomacisë së zhvilluar në forma tipike amerikane në favor të pavarësisë së Kosovës.

Një gjë dua ta them. Unë kam miqësitë e mia të mëdha në SHBA prej një kohe të gjatë. Janë miqësi për të cilat as nuk mburrem dhe as nuk abuzoj. Që herët kam njohur Presidentin e madh të SHBA-ve, mikun më vendimtar të Kosovës, Bill Clinton. Kam njohur dhe të tjerë presidentë, apo zyrtarë të lartë amerikanë, njohje të cilat u shpeshuan shumë në periudhën e lobimit për pavarësinë e Kosovës. Gjithmonë dhe për më shumë prej asaj periudhe kam patur bindjen e përfortuar për rolin themelor të SHBA-ve në çlirimin e Kosovës, pavarësimin e saj, dhe ecjen përpara drejt një shteti të ri. Mirënjohja për këtë rol duhet të jetë pjesë e pashlyeshme e kujtesës sonë kombëtare, gjegjësisht të kosovarëve. Kjo aleancë përcaktoi një nga zhvillimet më të rëndësishme, jo thjesht të kombit, por dhe të kohës që jetojmë: pavarësimin e Kosovës. Sekretarja amerikane e shtetit ka thënë në vizitën e saj në Tiranë: Do jemi bashkë dhe 100 vjet të tjerë!

Ndoshta në kohë të tjera, ky objektiv-që SHBA-të të pozicionoheshin publikisht pro pavarësisë sonë-mund të ishte më i lehtë, apo më i vështirë, në varësi të koniunkturës ndërkombëtare. Ndoshta, siç thotë një komentator i rëndësishëm kosovar, ne vetë kemi humbur kohë dhe kemi bërë gabime, diçka që ka sjellë për pasojë humbjen e koniunkturës së favorshme. Për të kuptuar më mirë këtë proces janë dhe shënimet e mia që tregojnë pikërisht se në cilin kontekst kohor zhvilloheshin ngjarjet. Kështu, ata që e lexojnë librin, e kuptojnë më mirë diçka që sot mund të duket e lehtë, apo e thjeshtë. Po flas për të rinjtë e sotëm apo të nesërm që nuk i kanë jetuar në vetë të parë ato kohë dhe që e kanë pavarësinë e Kosovës pjesë normale të jetës së tyre. Nuk po flas për skeptikët, apo për ata që vazhdimisht do pyesin se çfarë uji i ke dhënë gomarit dhe për secilën përgjigje, e kanë reagimin e tyre kritik, gjegjësisht keqdashës.

Si çdo shqiptar që kishte dëgjuar për Presidentin Uilson (Wilson) dhe parimet e tij mbi vetëvendosjen e popujve, të cilat shërbyen për të ruajtur integritetin territorial të Shqipërisë si shtet, e kisha adhuruar dhe dashur Amerikën që në fëmijëri. Edhe më shumë do ta doja pas asaj që bëri për të ndaluar gjenocidin mbi popullin tim në Kosovë. Kështu, angazhimi që SHBA-të kërkonin përfundimisht (publikisht) pavarësinë e Kosovës, për mua ishte një sfidë plot emocion. Ishte vijim i një vepre të lënë përgjysmë.

Siç kam lënë të kuptoj, asnjëherë në punën time nuk kënaqem me çfarë kam bërë dhe nëse më jepet rasti ta bëj sërish një punë, do ta përkryej atë. Kështu e kam parë dhe kontributin tim për Kosovën: unë asnjëherë s'kam qenë i kënaqur me çfarë kisha bërë dhe sapo më jepej rasti vendosja të angazhohesha për të bërë më shumë. Në të gjithë çështjet ku unë mund të ndihmoja më shumë se të tjerët. Çfarë mund të kontribuoj unë në bazë të analizës që herë pas here bëja mbi ngjarjet në Kosovë dhe përfshirjen e faktorëve ndërkombëtarë atje?

Cila ishte analiza që bëja asokohe në vitet e para të mijëvjeçarit të ri? Menjëherë pas asaj që ndodhi me sul-min burracak të 11 shtatorit 2001 në SHBA, mjerisht, edhe në opinionin publik amerikan apo dhe më gjerë, Kosova humbi rëndësinë e vet të mëparshme në planin ndërkombëtar, veçanërisht sa i takon zgjidhjes përfundimtare të statusit të saj. Madje, ngjarjet e vitit 2004, kur në Kosovë pati incidente të natyrës ndëretnike me humbje jetësh njerëzore, filluan të kontribuonin negativisht për imazhin tonë si Kosovë, duke ushqyer me argumenta të sforcuar kundërshtarët e pavarësisë sonë. Ajo që ndodhi pas çlirimit kur rolin kryesor po e merrnin jo vendorët, por ndërkombëtarët që nuk kishin apo nuk donin të merreshin me gjithçka nevojitej, bënë që Kosova të humbte pak nga pak shanset e krijuara të rritjes me çlirimin e saj në 1999.

Dukej sikur çështja e statusit po shtyej vazhdimisht. Kosovarët ishin të hendikepuar për shkak të dokumenteve të udhëtimit që nevojitej për t'i dhënë frymëmarrje një shoqërie të izoluar dhe post-traumatike. Sërbia po bënte presion të madh diplomatik për frenimin apo kthimin pas të rrotës së historisë. Lobi sërb po rriste këtë presion sidomos në SHBA, ku shquhej një zyrtar i lartë amerikan me origjinë sërbe, guvernatori i Illinoisit, Rod Blagojevich, i lidhur me Kishën sërbe. Sërbia po intensifikonte vizitat e emisarëve të vet në vendin që kishte udhëhequr procesin për një Kosovë të re. Rastësisht ose jo, pak para se të takohesha me nënsekretarin e përgjithshëm të OKB-së Sabaan, po diskutoja me këshilltarin tim Puskar për dëmet e Blagojevich dhe supozoja se vetëm një forcë madhore mund ta ndalonte këtë njeri. Pas takimit me zyrtarin e lartë të OKB-së, duke ndenjur në një bar, televizioni CNN po jepte me gërma të mëdha arrestimin e tij për korrupsion.



Presidenti Pacolli së bashku me Presidentin Mesiç. Nga ky takim lindi ideja për lobim në SHBA.

Më kujtohet se në një televizion lokal amerikan kam parë kreun e kishës ortodokse të Kosovës, Vladika Artemije, i cili fliste me gënjeshtër, se Kosova asnjëherë s'do të jetë e aftë të ndërtojë shtet, shqiptarët s'janë të aftë të ndërtojnë shtet, të ruajnë familjet e tyre. Është ky Artemija i famshëm që dihet se si përfundoi sot. Një firmë amerikane ligjore si Venable vendosi përkundrejt një pagese të mirë të përfaqësuar interesat e Këshillit Amerikano-Sërb duke mundur shumë vizita të zyrtarëve të lartë sërbë me synim lobimin kundër pavarësisë.

E kuptova asokohe, por dhe miqtë më sugjeruan, se beteja për Kosovën vendosej në Uashington. Kisha udhëtuar shpesh atje, por tanimë po kthehesha me një mision të madh. Shkova në SHBA dhe fillova me disa miq të mi të punoj, intensifikova kontaktet me senatorë e kongresmenë, por kjo nuk mjaftonte. SHBA-të ishin shumë të angazhuara në problemet e veta në Afganistan, Irak më pas, dhe për Kosovën nuk flitej thuhet fare publikisht- duke u zhvendosur nga prioritetet e politikës së jashtme. Kështu mendova të bëja diçka më profesionale. Pas ngjarjeve të vitit 2004, kur Kosovës iu cënoa imazhi, shkova në SHBA ku kontaktova një kompani lobuese që ma prezantoi presidenti Mesiç, e cila kishte ndihmuar kroatët më parë.

Kompania quhej *Jefferson Waterman International Group*, dhe ajo mori përsipër për të lobuar në SHBA dhe BE, dy faktorët vendimtarë që duhej të mbështesnin publikisht pavarësinë e Kosovës. Ne diskutuam gjatë rreth objektivit, kohës së mbërritjes së tij, mjetet për ta arritur. Objektivit ishte qartësisht PAVARËS-IA. Në mjediset e veta, brenda një kohe të shkurtër grupi ynë lobues vendosi një qendër për Kosovën, e cila filloi të frekuentohej nga miqtë që punonin për kauzën tonë.

Ata hapën një departament të tërë, si një miniambasadë, për t'u patur zili. Këtu u themelua Aleanca për Kosovën e Re, me statutin e vet, planin e veprimt, etj. Ajo filloi të ringjallë temën e Kosovës, të motivojë njerëzit kyç në Shtëpinë e Bardhë, Departamentin e Shtetit, Kongresin, Këshillin e Sigurisë Kombëtare, për një problem që pothuajse ishte harruar në opinionin publik amerikan. Kjo ringjallje do duhej t'i përshtatej politikës së Bushit, politikë që më vonë e quajti Kosovën histori të suksesit. Qendra për Kosovën përfshinte Uiliam Uoker (William Walker), Janus Bugajski, zyrtar për Evropën Juglindore në Këshillin për Studime Ndërkombëtare Strategjike të drejtuar nga Henri Kisinxhër (Henry Kissinger), Sem Haçkinsën (Sam Huchkinson), një ish-zyrtar i lartë amerikan, Frenk Karluçi (Frank Carluçi), ish-sekretar amerikan i mbrojtjes, Morton Abramovic (Morton Abramovitz), ish-ambasador amerikan, etj. Ishin figura që kishin akses të madh në të dy krahët e politikës amerikane, për më shumë në administratën Bush.

Ishte maksimumi i përqëndrimit të figurave: disa ish-sekretarë të mbrojtjes, disa të jashtëm, disa këshilltarë të sigurisë kombëtare në administrata të ndryshme, praktikisht vendimmarrës të nivelit të lartë në administratat e tyre. Waterman u përplas me qeverinë serbe, e cila, siç e thashë, lobonte gjithashtu në Uashington. Grupi im sensibilizoi çiftin Clinton-Hillarin dhe Billin, ambasadorin e ndjerë Holbruk, etj., duke i informuar me atë që ndodhte në terren, me probleme të ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës, etj. Miqtë tanë lobistë i jepnin bashkëbiseduesve argumente të forta nga pikëpamja ligjore dhe e sigurisë, pro pavarësisë së Kosovës.

Kur nevojitej, unë lija biznesin duke udhëtuar sa në Evropë, në SHBA, në Azi, etj. Lobistët e thirrur prej meje, bënë diçka dhe në Bruksel, Paris, Gjermani, gjithashtu, megjithëse fokusi ishte Uashingtoni. Çdo njeri me peshë në këtë qendër të rëndësishme të vendimmarrjes globale e dinte se çfarë bënte grupi ynë. U kontaktuan zyrtarë përgjegjës të Serbisë, Kroacisë, në Departamentin e Shtetit, u takuan ambasadorë të vendeve fqinje me Kosovën, organizoheshin seanca dëgjimi në institucionet amerikane, OJQ-të me peshë. Çdokush tjetër fliste për autonominë, miqtë tanë vetëm për pavarësinë, si zgjidhja e vetme. Madje, jo për pavarësinë e kushtëzuar, por për pavarësinë e plotë.

Ata morën përsipër që të prodhonin artikuj në mediet më të rëndësishme amerikane, të publikonin intervista të figurave pro pavarësisë së Kosovës, ata vendosën kontakte të qëndrueshme qoftë me Shtëpinë e Bardhë, me Kongresin, me komitetet e ndryshme të tij, me Departamentin e Shtetit dhe me Komitetin Kombëtar të Sigurisë, por punuan shumë dhe në planin ekonomik. Ata, madje, e ndërlihdën vendosjen e pavarësisë, me krijimin e një hapësire ekonomike të përbashkët në rajon.

Ky fokusim te ekonomia, për të cilën unë isha ideator, vinte prej një bindjeje personale që unë kisha mbi forcën e ekonomisë në amortizimin e problemeve apo ndarjeve etnike dhe kombëtare. Unë gjithnjë kisha bindjen se ky lobim pro pavarësisë duhej të shoqërohej krahas këtyre lloj aktiviteteve edhe me lobim për zhvillimin ekonomik të rajonit si një i tërë. Ndaj unë mbështeta fuqimisht krijimin e korporatës SEED, South Eastern Economic Development (Zhvillimi Ekonomik Juglindor), e cila organizoi konferenca të ndryshme në Uashington me pjesëmarrjen e biznesit të nivelit të lartë amerikan, por dhe jashtë SHBA-ve, për t'u njohur me zhvillimet ekonomike në rajon. U prodhuan dokumente të ndryshëm politikë, programorë, që u vunë përpara kongresmenëve të dy krahëve për t'i informuar ata për zhvillimet në terren.

Në ndikimin e këtij grupi pune, u zhvilluan seanca pyetjeje në Kongres, ku pa dyshim më e rëndësishmja ishte seanca e 8 nëntorit 2005 që pa të përfshirë ish-senatorin, zëvendëspresidentin amerikan të sotëm Xhozef Bajden (Joseph Biden), nënsekretarin amerikan të shtetit Bërns (Burns), dhe ish-ndihmës Sekretarin e shtetit Holbruk (Richard Holbrooke).

Bajdeni, ky mik i madh e i sprovuar i kombit shqiptar, djali i të cilit, Beau, kishte punuar në Kosovë për Departamentin e Drejtësisë në një program për të mbështetur sistemin e drejtësisë në vendin tonë, tha se situata e krijuar në terren nuk mund të tolerohej, se shqiptarët meritonin të shpërbleheshin, etj. Po ashtu, Holbruku dhe Bërns u shprehën pro një forme statusi që nuk lejonte kthimin në gjendjen e para



Joseph Biden dhe Richard Lugar gjatë një sesioni të Komisionit të Politikës së jashtme të Senatit Amerikan.

1999, apo ndarjen e Kosovës. Sigurisht, Hollbruku ishte më i drejtpërdrejtë, pasi ai nuk ishte pjesë e administratës si sot. Sot, këto propozime duken si kufizuese, por duhet vërtet të kuptojmë atmosferën e kohës, duhet të kuptojmë evoluimin e pozicioneve të administratës që kishte sigurisht një bazament, qoftë te politika e administratës demokrate, qoftë dhe te Bushi i vjetër, i cili kishte folur i pari për vijën e kuqe të Beogradit në Kosovë.

Bajden shkroi artikuj të ndryshëm, madje dhe në Wall Street Journal. Shumica e anëtarëve të grupit tonë kishin akses në medie të tilla të rëndësishme si kjo gazetë, apo në Uashington Post, Uashington Times, etj ku ata botuan artikuj të shumtë. Bugajski shkroi , për shembull dhe kundër rolit rus në Ballkan, pikërisht në WSJ. Konferenca që mbajtëm në 2006, organizuar prej Aleancës Kosova e Re, pati një pakt të madh në SHBA.

Në gazetatat dhe mediet më të mëdha amerikane, Karluçi, Abramovic, Bugajski, kërkonin drejtpërdrejtë nga çdo dashamirës i lirisë në Amerikë për të përkryer punën e nisur me bombardimet e vitit 1999. Kjo u bë si një lloj detyrimi për miqtë tanë që e shndërruan Kosovën në çështje elektorale. Kur shkoje në institucionet amerikane dhe prezantoheshe si nga Kosova, ata pyesnin: aha, po loboni për pavarësinë e Kosovës! Kompania u bë simbol i këtij objekti. Mes arritjeve të lobimit kah medias amerikane dua të kujtoj një paraqitje në Qendrën e Mediave Ndërkombëtare në Uashington, me një prani shumë të madhe të gazetarëve.

Me këtë lobim të vazhdueshëm mund të them pa modesti, ne ia arritëm ta rikthenim Kosovën në vëmendjen amerikane. Në këtë kuadër, edhe vetë jam takuar vazhdimisht me krerë institucionesh të rëndësishme në Departamentin e Shtetit, në Senat, në Shtëpinë e Bardhë. Filloi të flitej, edhe pse jozyrtarisht se Kosova duhej të pavarësohej. Asokohe ne përplaseshim me lobin serb, dhe mora informacione nga miqtë e mi me ndikim në Uashington se duhet të mendoja më shumë për sigurinë time, pse jo dhe në Lugano.

Unë nuk mora ndonjë masë të veçantë sigurie, por vendosëm të shumëfishonim përpjekjet tona për të mundur lobin serb i cili u aktivizua shumë, jo thjesht në Kongres, por dhe në vigjilje të mbledhjeve të përvitshme të nivelit të lartë të OKB-së, duke shfrytëzuar koniunkturën e re botërore dhe amerikane.

Nuk ka asnjë diskutim se ne e gjenim në forma të ndryshme prirjen pro pavarësisë së Kosovës brenda administratës republikane, apo në qarqe të tjera. Pra, ne nuk ishim aktorët e vetëm që përcaktuam kursin e mbështetjes amerikane të nivelit më të lartë për pavarësinë, por, sigurisht, ne ishim jashtë qeverisë amerikane, aktorët më cilësorë siç duket nga përbërja e aktivistëve tanë.



Presidenti Bush gjatë vizitës në Shqipëri.

Por, pa dyshim, momenti më kulmor i lobimit tonë ishte futja e frazës “KOSOVA DUHET TË JETË NJË SHTET I PAVARUR, TANI”, në fjalimet e Bushit gjatë vizitës në Shqipëri në qershor të vitit 2007. Ishte praktikisht kurorëzimi i punës sonë të madhe me miqtë që përmenda dhe miqtë e miqve. Nuk di të them se kush tjetër ka punuar në favor të pavarësisë dhe s’jam duke pretenduar për ekskluzivitet, por unë flas për punën time dhe të miqve të mi. Të tjerët le të flasin për punën e tyre.

Si punuam për këtë objektiv?

Kur u vendos që Bush të vizitonte Shqipërinë, unë dhe miqtë e mi patëm rastin që me njerëzit më të afërt të presidentit të njihnim dhe diskutonim për axhendën që po diskutohesh dhe me ambasadën shqiptare në telefon. Mbjaj mend se punuam shumë, u desh shumë kohë që ajo fjalë të vendosej në gojën e tij deri në orën 4 të mëngjesit, në bashkëpunim me një mik tonin që punonte në Administratën e lartë të Presidentit Bush dhe që vinte prej Zvicrës dikur.

Unë e kam ditur, pra, dhe nuk e kam thënë kurrë më parë se Bush do të përmendte fjalën magjike PAVARËSIA, dhe se kjo ishte fryt i lobimit tonë.

Ardhja e tij në Shqipëri, pritja madhështore që iu rezervua, ia nxori këtë fjalë jo vetëm nga mendja, por dhe nga shpirti. Unë pata rastin që ta falënderoja personalisht Presidentin Bush për këtë nder të madh që i bëri Kosovës. Më 4-5 prill të vitit 2008, ai vizitoi Zagrebin dhe miku im, Presidenti Mesiç, më ftoi që të merrja pjesë në disa prej aktiviteteve të tij. Kështu arrita ta takoja në hotelin ku ai rrinte dhe t’i dhuroja një pikturë që riprodhonte një foto familjare të Bushit, me gruan dhe vajzat. Ishte një pikturë e jashtëzakonshme e autorit nga Shqipëria, të famshmit Zef Shoshi, e cila e la pa fjalë Presidentin Bush. I thashë se “ju keni bërë shumë për Kosovën, ju jeni i pari që keni folur për këtë pavarësi dhe unë dua t’ju lë këtë pikturë si kujtim!” Zoti Bush më tha se “kam marrë shumë dhurata, por kjo sigurisht është diçka e paharruar që do ta marr me vete në shtëpinë time.” Dhurata ishte zgjedhur në mënyrë të tillë që Presidenti Bush të mos e harronte Kosovën- një portret familjar, që ai mund ta çonte në shtëpinë e vet, ku do ta sodiste më shpesh se një dhuratë tjetër tipike.



Presidenti Bush së bashku me familjen e tij, pikturë e autorit të njohur shqiptar Zef Shoshi, që unë ia dhurova arkitektit të pavarësisë në Zagreb.

Me këtë fjalë të Bushit në Shqipëri, me vizitën e suksesshme në vendin amë, me pritjen që iu rezervua, lobimit iu hap një horizont i ri. Gjithçka u bë më e lehtë. Lobistët tanë realizuan takime me think-tank-et kryesore amerikane ndaj që në 2005 dhe 2006 ne arritëm të vendosnim kontakte me CSIS-in, ndoshta organizatën më të madhe studimore dhe me ndikim në politikën e jashtme amerikane, që u shndërruan në marrëdhënie shumë intensive duke përfshirë edhe ata në lobim. CSIS mbante brenda vetes tre prej këshilltarëve aktualë të Presidentit Obama dhe disa ish-sekretarë të mbrojtjes, ish-këshilltarë të sigurisë kombëtare, figura kyçe në formulimin e politikës së SHBA-ve.

Për rëndësinë e vet jo vetëm në nivel amerikan, por dhe global, CSIS (Center for Strategic and International Studies- Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare) vizitohej nga burrështetas evropianë që vinin dhe mbanin fjalime në konferenca apo në mjediset e kësaj organizate të drejtuar siç thashë nga Kissinger. Kjo mundonte që lobi-mi të orientonte ndikimin tek vendet anëtare të BE-së. Më kujtohet p.sh., ardhja e krerëve të shteteve evropiane në CSIS, mes të cilëve presidenti francez Zhak Shirak. I pyetur për çfarë mendonte për Kosovën, menjëherë pas vizitës së zotit Bush në Tiranë, ai tha: "siç e dini, Presidenti Bush ka menduar për këtë gjë". Organizoheshin konferenca dhe gjatë drekës, njerëzit që punonin, që lobonin, diskutonin me të ftuarit e tjerë. Në vitin 2006, mua më propozuan që të jem këshilltar i përhershëm ndërkombëtar i komitetit të udhëhequr nga Kissinger, komiteti më me rëndësi i CSIS-së. Ne mblidhemi çdo tre muaj, dhe komiteti është një urë lidhëse me shtete të tjera. Për mua është lehtësi shumë e madhe që të lidhem me burrështetasit e botës, sidomos ata që më interesojnë mua- ata që duan ta njohin Kosovën.

Me Kissingerin, këtë burrë të jashtëzakonshëm që është shprehur shumë herët për pavarësinë e Kosovës në Foreign Politics jam gjithnjë në të njëjtën tavolinë në të gjithë aktivitetet ku marr pjesë. Ai thotë mes të tjerash duke iu referuar Kosovës se "duhet harruar dhuna, duhet shikuar përpara. Me zhvillimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, mos u ndalni në problemet banale. Ju duhet të arrini qëllimet tuaja, duke angazhuar tërë potencialin tuaj. Të radhiteni si shtet i dëshmuar pozitivisht. S'ka rëndësi mënyra, ajo ju lihet juve. Shfrytëzoni çdo energji. Duhet të jeni unikë, pavarësisht se cilës palë i përkisni, opozitës apo qeverisë, duhet të jeni unikë".



Me Zbigniew Brzezinski, gjeostrategjistin e madh amerikan dhe Janusz Bugajskin.

Gjatë këtyre takimeve në CSIS, unë jam njohur dhe me gjeneralin Xhejms Xhons (James Jones), aktualisht këshilltari për Sigurinë Kombëtare i Presidentit Obama, si dhe me atë që më pas u bë këshilltari i Obamës për ekonomi, Pol Uokër (Pol Wolker). Jemi takuar dhe kemi bashkëbiseduar disa herë jo thjesht për Koso-vën, por dhe për çështje të ndryshme të rajonit apo më gjerë. Më kujtohet një episod interesant gjatë takimeve me këta personalitete të rëndësishëm të skenës politike amerikane. Gjatë një konference për krizën ekonomike, të gjithë po flisnin për humbjen e parave dhe skemat Financiare. Unë pyeta: “ku shkuan paratë? Ku shkoi cash-i?”, Paul Wolker u përgjigj: “ju zoti Pacolli mund ta dini më mirë se çdo njeri tjetër”.

Unë e dija se ai e njihnte aktivitetin tim biznesor dhe që unë harxhoja mjete të shumta për çështjen e Kosovës. Duke ndjekur këtë moment, Kissingeri më shkroi një mesazh në stilin e vet në copa letre: “Ju bëtë pyetjen më të mirë”. Gjatë pjesëmarrjeve të mia në CSIS, kam patur kontakte me Zbignju Brzezinski (Zbigniew Brzezinski), një Figurë autoritare e studimeve strategjike, diplomatike amerikane, përveçse vendimmarrës në cilësinë e këshilltarit për çështje të sigurisë kombëtare të një presidenti amerikan. Ai ka premtuar të vijë në Kosovë dhe më ka thënë ndërsa flisnim për sfidat ndërkombëtare të Kosovës se “ju duhet të keni rrjet të zhvilluar diplomatik. Ju nuk mund të dominoni me para dhe me politikë. Kosova s’mund të jetë një qendër ku zhvillohet politikë me rëndësi për Evropën dhe botën. Ju duhet që të aktivizoni gjithë kontaktet tuaja nëpër botë. Ju duhet të përkujdeseni për minoritetet, të bashkëjetoni me ta. Kufijtë tuaj s’duhet të lëvizin asnjëherë. Nuk duhet të bashkoheni sepse bashkësia ndërkombëtare do të demoralizohet nëse do të dilni nga ai format i përcaktuar më parë prej saj”.

Ky angazhim imi në SHBA do të thoshte përkushtim i madh financiar për gjashtë vite me radhë duke arritur disa milionë dollarë, të cilat unë i kam dhënë pa mëdyshje për vendin tim. Ia arritëm qëllimit, ama: në vitin 2007 grupi lobues e përmbylli punën e tij, sepse konsideroi se Departamenti i Shtetit dhe Shtëpia



George W. Bush në Tiranë. Sapo tha fjalën magjike: Pavarësi!

e Bardhë tashmë ishin të qartë në qëndrimin e tyre për pavarësinë e Kosovës. Ardhja e Bushit në Shqipëri dhe shprehja e tij decizive se Kosova do të bëhet e pavarur, ishte epilogu që i përmbylli të gjitha rreth qëndrimit zyrtar të Uashingtonit. Që atëherë, për mua, pavarësia e Kosovës ka qenë çështje e përfunduar në pikëpamje të vendosjes së saj prej faktorëve më të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Pas shpalljes së pavarësisë vendosa që puna të mos ndalej, por prioriteti kishte ndryshuar-njohja e saj nga shtetet e ndryshme. Zgjedha partnerë të tjerë. Fillova të lloboj sërish me ndihmën e CSIS, por jo vetëm të saj. Në aktivitetet e organizuara atje kam takuar krerët e Salvadorit, mbretin e Jordanisë, shumë liderë të vendeve islamike, kryesuesen e UNICEF-it, nënsekretarin e OKB-së, Muhammad Shaaban, shumë zyrtarë afrikanë me të cilët jam dakorduar t'i vizitoj në vendet përkatëse. P.sh., aty kemi patur presidentin e Bregut të Fildishtë, i cili më ftoi për vizitë në vendin e tij. Krerët e Ganës, gjithashtu. Direkt ose indirekt, një pjesë e madhe e lidhjeve të mia ndërkombëtare në funksion të njohjes vijnë prej atje, prej CSIS. Por nuk kanë qenë vetëm kontakte të nivelit të lartë politik: kam hapur horizonte të reja jo thjesht gjeografike, por dhe mediatike, etj. Kam kontaktuar me shumë organizata, me universitete anembanë globit, etj. Prej lobimit në Amerikë, hodha kështu prej njohjeve personale, prej eksperiencës së krijuar diplomatike, një bazë të re të lobimit tim të mëtejshëm pro njohjes së shtetësisë së Kosovës, për të cilën do të flas në një libër tjetër...

Prej lobimit në SHBA, unë krijova një bagazh njohjesh, ekperience, miqsh, koncepti politik, subjekti politik mbi bazën e të cilit unë vendosa të ndikoja zhvillimet tashmë në vendin tim, në Kosovë. Vendosëm transformimin e AKR në parti politike, parti që siç tregohet në këtë libër ka lindur në SHBA. Është një parti liberale, e lindur sipas parimeve perëndimore, e themeluar mbi punën, mbi konceptet e integritimit ekonomik. Nuk ka parti tjetër që ta ketë çertifikatën e lindjes në SHBA... Vijova lobimin në katër kontinentet dhe solla dhjetra njohje, por për to do të flas në vëllimin e dytë të lobimit për Kosovën.

KALENDARI I FAKTEVE DHE QËNDRIMEVE NDËRKOMBËTARE GJATË LOBIMIT TIM

- **Dhjetor 2003:** Bashkësia ndërkombëtare, BE dhe OKB, përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Harri Holker, iu dorëzoi autoriteteve kosovare dokumentin: “Standardet për Kosovën”. Tashmë, të gjitha kërkesat për zgjidhjen e statusit nga ndërkombëtarët përgjigjeshin me “standardet para statusit”¹

Dokumenti ”Standardet për Kosovën” përmbante këto tetë pika:

- 1) Institucionet demokratike funksionale
- 2) Sundimi i ligjit
- 3) Liria e lëvizjes
- 4) Kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre
- 5) Ekonomia
- 6) Të drejtat pronësore
- 7) Dialogu
- 8) Trupat Mbrojtëse të Kosovës

-
- **17 mars 2004:** Filluan trazirat që më vonë janë përfolur shumë si “Trazirat e marsit”. Gjatë këtyre trazirave u dogjën disa shtëpi dhe kisha serbe (më saktësisht 4000 serbë janë shpërngulur nga shtëpitë si dhe 30 kisha ortodokse serbe në territorin e Kosovës u dogjën, rindërtimi i të cilave u financua nga buxheti i Kosovës. Këto trazira zgjuan nga gjumi shumë vendimmarrës. Të gjithë e kuptuan se shumë pak mund të përmirësohej Kosova pa zgjidhjen e statusit përfundimtar. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan, i dha detyrën norvegjezit, Kai Eide, për hartimin e një raporti që do të pasqyronte situatën në Kosovë.

-
- **24 janar 2005:** International Crisis Group (Grupi Ndërkombëtar i Krizave) publikon raportin “Kosova drejt statusit final” ku konkludohet se pavarësia është zgjidhja më e mirë për Kosovën. Serbët si gjithmonë e refuzojnë atë.

-
- **Tetor 2005:** Kai Eide, ambasador i Norvegjisë në NATO, i dorëzon Kofi Annan raportin mbi gjendjen e përgjithshme në Kosovë. Eide i rekomandon Annan fillimin e bisedimeve për statusin. Politikanët shqiptarë të Kosovës e karakterizojnë raportin si të drejtë.

-
- **10 nëntor 2005:** Këshilli i Sigurimit të OKB-së aprovon emërimin e Martti Ahtisaari nga Kofi Annan, si përfaqësues special për statusin e ardhshëm të Kosovës. Zëvendës i Ahtisaarit emërohet austriaku, Albert Rohan.

¹ Me qëllim të kuptimit më të mirë të kontekstit kohor, pra se cilat ishin veprimet dhe qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare, gjegjësisht të SHBA-ve, kundrejt Kosovës, unë po ju ofroj këtë kalendar. Kështu do kuptohet më mirë pse unë vendosa që nëpërmjet lobimit në SHBA të përcaktoja gjithë qëndrimin botëror, ose të fuqive kryesore në favor të pavarësisë së Kosovës.

- **21 nëntor 2005:** Martti Ahtisaari viziton Kosovën për herë të parë që nga emërimi si përfaqësues special për statusin e ardhshëm të Kosovës. Ai bën takime me kryeadministratorin e OKB-së, Soren Jessen-Petersen, presidentin Ibrahim Rugova, kryeministrin Bajram Kosumi, përfaqësues të opozitës dhe minoritetit sërb. Në të njëjtën ditë, proteston lëvizja “Vetëvendosje” me parullat: “Jo negociata-Vetëvendosje”.

- **22 mars 2006:** Këshilli Kombëtar Sërb nënshkruan një kontratë me firmën amerikane “Venable”. Kjo kontratë u ndërmjetësua nga James Jatras, i cili është pjesëtar i këtij këshilli nacionalist dhe antishqiptar. Qëllimi kryesor me këtë kontratë është demonizimi i shqiptarëve në prag të statusit. Vlera e kontratës sipas medieve ishte 600.000 dollarë në muaj.

- **19 maj 2006:** Ministrja e jashtme e Zvicrës, Micheline Calmy-Rey, ka përsëritur thirrjet për njohjen formale të pavarësisë së Kosovës.

- **12 qershor 2006:** Petersen lajmëron largimin e tij nga Kosova. Analistët thonë se po e lënë Kosovën për shkak të deklaratave pro pavarësisë.

- **24 korrik 2006:** Takimi i zyrtarëve më të lartë të Kosovës dhe Sërbisë në pallatin Niederösterreich, Vjenë, Austri. Të pranishëm janë: Agim Çeku (kryeministër i Kosovës), Fatmir Sejdiu (president i Kosovës), Vojislav Koštunica (kryeministër i Sërbisë), Boris Tadic (president i Sërbisë) dhe anëtarë të tjerë. Siç është pritur, nuk arrihet asnjë marrëveshje, por Ahtisaari e konsideron të suksesshëm për faktin se këta liderë janë takuar ballë për ballë. Në Kosovë, ky takim u përshkrua si «takimi i elefantëve». Lëvizja «Vetëvendosje» proteston në Prishtinë kundra këtyre bisedimeve.

- **27 korrik 2006:** Ultranacionalisti, Tomislav Nikoliç, lider i Partisë Radikale të Sërbisë, kërcënoi me luftë nëse Kosova merr pavarësinë.

- **28 korrik 2006:** Grupi Ndërkombëtar i Krizave publikon raportin “Armë për Kosovën?”, ku thuhet se Kosova duhet të ketë ushtrinë e vet pas zgjidhjes së statusit, që sipas tyre duhet të jetë pavarësia.

- **31 Korrik 2006:** Bëhet e ditur se qeveria sërbe ka nënshkruar një kontratë me firmën lobiste amerikane “Barbour, Griffith & Rogers” me vlerë 30 milionë dollarë. Edhe kësaj here dëshira kryesore ishte demonizimi i shqiptarëve.

- **7 gusht 2006:** Bisedimet mes autoriteteve kosovare dhe sërbe në Vjenë. Në fokus është decentralizimi. Delegacioni shqiptar drejtohet nga Veton Surroi. Pas mbarimit të këtyre takimeve thuhet se ka pasur progres minimal.

- **14 gusht 2006:** KofiAnnan emëron gjermanin Joachim Rüecker kryeadministrator të Kosovës. Rüecker para këtij emërimi kishte punuar për disa vite në UNMIK.

- **28, 29 tetor 2006:** Referendum në Sërbi për kushtetutën e re që u hartua brenda disa muajve pa debate publike. Në kushtetutë nënvizohet se Kosova është «pjesë e pandarë e Sërbisë». ICG, Grupi Ndërkombëtar i Krizave në raportin me titullin «Sërbia's New Constitution: Democracy Going Backwards» (Kushtetuta e re e Sërbisë: Demokracia po ecën me hapa mbrapa) kritikon përmbajtjen dhe mënyrën se si është hartuar Kushtetuta.

- **Dhjetor 2006:** Bëhet e ditur se publikimi i propozimit të Ahtisaarit për statusin përfundimtar të Kosovës do të shtyhet deri në janar 2007 me mundësi për shtyrje të mëtejshme.

- **21 janar 2007:** Zgjedhjet parlamentare në Sërbë. Propaganda “Kosova është Sërbë” në qendër të fushatës elektorale. Por politikani, Čedomir Jovanović, nga partia Liberal Demokrate tha se ai do të nënshkruante pavarësinë e Kosovës. Këto zgjedhje që në të vërtetë ishin të paplanifikuara dhe u përcaktuan pas referendumit për Kushtetutën ishin shkaku që Ahtisaari shtyu publikimin e rekomandimit të tij në lidhje me statusin. Pritej që Ahtisaari të rekomandonte pavarësi dhe bashkësia ndërkombëtare kishte frikë se bërja publike e rekomandimit para zgjedhjeve do të rriste përqindjen e partive radikale në Sërbë.

- **24 janar 2007:** Asambleja e Këshillit të Evropës (Council of Europe) miraton rezolutën 1533 në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës. Disa nga nenet e projektrezolutës që u paraqitën para përfaqësuesve nga e gjithë Evropa u hoqën për shkak se disa përfaqësues të prirë nga Sërbia, Rusia dhe Greqia votuan kundër inkuadrimin të tyre në rezolutën përfundimtare. Njëri nga nenet ishte dhe ai për pavarësinë ku thuhej se Kosova duhet të merrte pavarësi për të siguruar paqe në Ballkan. Rezoluta që u miratua nuk përmbante fjalën pavarësi, por nënvizonte se një zgjidhje e negociuar preferohej nga ky Këshill, por nëse kjo zgjidhje nuk do arrihej, atëherë do ishte nevojshme që zgjidhja përfundimtare të imponohej.

- **26 janar 2007:** Ahtisaari zhvillon takim me të ashtuquajturin Grupi i Kontaktit që përbëhet nga SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia. Nuk kishte deklarim për medie, sepse takimi ishte me dyer të mbyllura, por njoftohet se Ahtisaari do të propozonte pavarësi të kushtëzuar. Në të gjitha shtetet e botës njoftohet se Kosova do të marrë pavarësi të kushtëzuar. Mediet lajmërojnë se Rusia është skeptike në lidhje me planin e Ahtisaarit. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, holandezi Jaap de Hoop Scheffer shprehet se NATO përkrah planin e Ahtisaarit në lidhje me statusin e Kosovës.

- **02 shkurt 2007:** BIRN (Balkan Investigative Reporting Network) publikon nenet kryesore të planit të Ahtisaarit. Disa orë më vonë Martti Ahtisaari dorëzon propozimin e tij në Beograd dhe Prishtinë. Edhe pse nuk përmendet fjala pavarësi, të gjithë, madje edhe presidenti i Sërbisë, Boris Tadić, janë të mendimit se ky propozim e çon Kosovën drejt pavarësisë.

- **10 shkurt 2007:** Lëvizja «Vetëvendosje» organizon protestë në Prishtinë kundër paketës së Ahtisaarit që sipas tyre nuk ofron pavarësi. Disa nga protestuesit filluan të përlesheshin me policinë (që përbëhej nga kosovarë dhe ndërkombëtarë).

- **14 shkurt 2007:** Stephen Curtis, shef i policisë ndërkombëtare në Kosovë, jep dorëheqje pas kërkesës së kryeadministratorit Joachim Ruecker.

- **21 shkurt 2007:** Negociata të reja në Vjenë që kanë për qëllim gjetjen e një kompromisi. Pas këtyre negociatave njoftohet se asgjë nuk është arritur dhe se qëndrimet e të dy palëve janë të njëjta: shqiptarët duan pavarësi, kurse sërëbet ofrojnë autonomi. Edhe Ahtisaari, por edhe ndihmësit e tij kishin sinjalizuar se këto negociata nuk do të sillnin asgjë. Albert Rohan, anëtar i ekipit të Ahtisaarit i tha BBC-së, se këto negociata janë shansi i fundit për kompromis.

- **10 mars 2007:** Në Vjenë të Austrisë përfundojnë bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës mes shqiptarëve dhe serbëve, pa asnjë marrëveshje. Të pranishëm ishin krerët e Kosovës (Fatmir Sejdiu, Agim Çeku, Kolë Berisha etj.) dhe Serbisë (Boris Tadiç, Vojislav Kostunica etj.) si dhe i dërguari i OKB-së për statusin, Martti Ahtisaari. Ahtisaari shprehu keqardhje që nuk është arritur asnjë marrëveshje. Ai njoftoi se dokumenti përfundimtar për statusin e Kosovës do t'i dërgohej Këshillit të Sigurimit të OKB-së në fund të atij muaji.

- **15 mars 2007:** Albert Rohan, bashkëpunëtor i Martti Ahtisaarit, i dorëzon OKB-së propozimin e Ahtisaarit për statusin e Kosovës. Sipas burimeve të agjencisë së lajmeve, Reuters, plani propozon pavarësi për Kosovën.

- **26 mars 2007:** Martti Ahtisaari i dërgon raportin përfundimtar Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku ai thotë se Kosova duhet të bëhet e pavarur. Nicholas Burns, zëvendësministër i jashtëm i SHBA-ve thotë se SHBA-të përkrahin planin e Ahtisaarit dhe mendojnë se Kosova duhet të bëhet e pavarur. Serbët vazhdojnë ta kundërshtojnë planin. Rusia bën deklaratë që mund të interpretohen si kundër pavarësisë, por nuk përmendet përdorimi i vetos.

- **29 mars 2007:** Parlamenti Evropian miraton një rezolutë ku shprehet përkrahja për pavarësi të mbikëqyrtur për Kosovën. 490 vota pro, 80 kundër dhe 87 abstenime.

- **3 prill 2007:** Fillon shqyrtimi i planit të Ahtisaarit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Pas dyerve të mbyllura është dëgjuar i dërguari special për Kosovën, Martti Ahtisaari, duke shpallur planin që pritet t'i jepte Kosovës një pavarësi të mbikëqyrtur.

- **5 prill 2007:** Kuvendi i Kosovës miraton një deklaratë për përcaktimin e statusit të Kosovës ku mbështetet propozimi i kryenegociatorit Martti Ahtisaari.

- **17 prill 2007:** Zëvendësministri i jashtëm i SHBA-ve, Nicholas Burns, në një fjalim para Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë në Uashington tha se Uashingtoni e konsideronte pavarësinë si opsionin më të përshtatshëm për Kosovën dhe se ai priste që Këshilli i Sigurimit të aproonte planin për pavarësi, të prezantuar nga i ngarkuari i posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari.

- **25 prill 2007:** Misioni faktmbledhës që përbëhet nga 15 ambasadorët/zëvendësambasadorët për në OKB të shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit arrin në Bruksel ku ka takime me të tjerash me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Scheffer. Scheffer iu tregon ambasadorëve se NATO përkrah planin e Ahtisaarit për t'i dhënë pavarësi Kosovës. Ambasadorët erdhën në Kosovë pas kërkesës së Ruisë që ka të drejtë vetoje në KS të OKB-së, për tu njohur nga afër me gjendjen e minoriteteve. Pjesëmarrës ishin ambasadorët e këtyre shteteve: SHBA-ve, Francës, Britanisë së Madhe, Kinës, Kongos, Ganës, Afrikës së Jugut, Katarit, Indonezisë, Sllovakisë, Panamasë, Ruisë, Belgjikës, Italisë dhe Perusë.

- **27 prill 2007:** Ambasadorët zhvillojnë takime me zyrtarët më të lartë të Kosovës: Presidentin, Kryeparlamentarin dhe Kryeministrin. Autoritetet kosovare prezantojnë të gjitha arritjet e tyre që kanë të bëjnë me minoritetet. Pas takimeve, ambasadori amerikan, Zalmay Khalilzad, dhe ai francez, Jean Marc de La Sablier, shprehen të kënaqur me përparimet në Kosovë, edhe kur bëhet fjalë për minoritetet.

- **13 maj 2007:** Një rezolutë e hartuar nga SHBA-të iu shpërndahet shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kjo rezolutë e çonte Kosovën drejt pavarësisë. SHBA-të vazhdojnë të deklarojnë se e përkrahin pavarësinë e Kosovës dhe se kjo duhet të vijë brenda muajit maj. Rusia thotë se nuk mundej t'i pranonte disa pjesë të rezolutës. Gazeta "Express" që gjeti një kopje të rezolutës shkruante të dielën e 13 majit: "Teksti i draft-rezolutës, të cilin Shtetet e Bashkuara të Amerikës me partnerët evropianë ia kanë prezantuar Këshillit të Sigurimit, nuk përmban fjalën pavarësi. Mirëpo, baza e këtij drafti është plani i Ahtisaarit, i cili çon drejt pavarësisë."

- **15 maj 2007:** Sekretarja amerikane e shtetit, Condoleezza Rice, thotë në Moskë: "Kosova kurrë më nuk do të jetë pjesë e Sërbisë. Kjo është e pamundur". Rusia vazhdon të shprehet kundra pavarësisë. Statusi i Kosovës ishte ndër pikat më të rëndësishme në takimet që Rice kishte në Moskë.

- **7 qershor 2007:** Në takimin e G8-s në Heiligendamm, Gjermani, Presidenti i porsazgjedhur francez Nicolas Sarkozy propozon që zgjidhja përfundimtare e statusit të Kosovës të shtyhet me gjashtë muaj, me kusht që Rusia të mos bllokojë rezolutën për pavarësinë e Kosovës, nëse një kompromis midis Prishtinës dhe Beogradit nuk gjendet brenda këtyre gjashtë muajve.

- **8 qershor 2007:** Për fundon takimi i G8-s. Nuk është arritur marrëveshje për pavarësinë e Kosovës, por kancelarja gjermane Angela Merkel thotë se diskutimet ishin konstruktive. Rusia vazhdon të jetë pengesa e vetme për pavarësinë e Kosovës. Zyrtarët kryesorë kosovarë i bëjnë apel komunitetit ndërkombëtar që të miratojnë sa më shpejt një projektrezolutë për pavarësinë. Propozimi për shtyrje refuzohet. SHBA-të vazhdojnë të këmbëngulin se pavarësia është zgjidhja e vetme dhe më e mirë.

- **10 qershor 2007:** Presidenti amerikan, George W. Bush, viziton Tiranën, hera e parë që Shqipëria vizitohet nga një president amerikan. Ai thotë se Kosova do ta marrë pavarësinë. Bush u mirëprit në mënyrë madhështore nga populli shqiptar.

- **Korrik 2007:** Pas dështimit të negociatave me Rusinë për një rezolutë në Këshillin e Sigurimit që do t'i hapte rrugën pavarësisë së Kosovës, çështja e statusit iu dërgua Grupit të Kontaktit që do të ndërmjetësojë në negociatat shtesë prej 120 ditëve midis Prishtinës dhe Beogradit. Shqiptarët vazhdojnë që të jenë kategorikë në kërkesën e tyre për pavarësi.

- **17 SHKURT 2008:** Kosova shpallet e pavarur.





BEHGJET ISA PACOLLI

Zëvendëskryeministër i parë i Republikës së Kosovës

DATA, VENDI I LINDJES, FAMILJA:

30 gusht 1951, Marec, Prishtinë. I biri i Isës dhe Nazmijes, i dyti nga 10 fëmijët, i martuar me znj. Masha Pacolli. Prind i gjashtë fëmijëve, tri vajzave dhe tre djemve (Arbreshës, Selenës, Hanës, Isës, Diarit dhe Armanit).

EDUKIMI:

Fillestar: Edukimi fillor në Marec – Kosovë.

I mesëm: Edukimi i mesëm në Prishtinë.

I lartë: 1970-1973 Instituti i Tregtisë së jashtme *Hamburg, Gjermani*.

Specializimi: 1982-1983 Master në Marketing dhe Menaxhment – Instituti *Mösinger Zurich*.

PROFILI PROFESIONAL, EKSPERIENCA:

1974-1975 – Korrespondent për gjuhë të huaja dhe zëvendës drejtor për zhvillim pranë *Kombinatit të Tekstilit*, Gjilan.

1976 – Drejtor komercial për zhvillim rajonal i Kompanisë *Peter Zimmer, Kufstein, Austri*.

1977-1980 – Drejtor komercial në kompaninë *Interplastica Project Engineering* në Morbio Inf. Zvicër.

1980-1990 – Drejtor Gjeneral *Interplastica Project Engineering* në Morbio Inf. Zvicër.
1990 – Themelues, President dhe titullar i *Mabetex Project Engineering*, Lugano Zvicër.
1992-2009 – President i CRS-*Credito per lo sviluppo e ristrutturazione*, Lugano Zvicër;
President i *Mabco Construction*, Lugano Zvicër
President i *Swiss Diamond Hotel Management*, Bermuda;
Pronar i Korporatës *Interfin Finance* Londër;
Pronar i *Mabetex International* (i shtrirë 18 vende të botës);
Pronar i kompanise së sigurimeve *Siguria*, Prishtinë;
Aksionar mazhoritar në *Bankën Ekonomike*, Prishtinë;
Pronar i *Saranda Properties*, Astana Kazakistan;
Pronar i *Sine Tempore International*;
Pronar i agjensionit *Diamond Travel*;
Pronar i *Nuova Bernasconi* – Lugano
Anëtar i bordeve drejtues në disa kompani nëpër botë

VEPRIMTARITË TJERA HUMANITARE:

Sponsor kryesor i Fondacionit *Aleksandër Moisiu*;
Themelues i Fondacionit dhe jetimoreve “*Bambini Di Sakha*”
1993 – Themelues dhe sponsor i spitalit për strehimin dhe përkujdesjen e fëmijëve të braktisur që lindin me probleme fizike në Sakha);
1999 – Në bashkëpunim me Fondacionin “*Insieme per la pace*” dhe zonjën Fanfani, intervenon masivisht në ofrimin e ndihmave në Kukës, Ivangrad, për të dëbuarit nga Kosova;
Mbështetje spitaleve në Kosovë me barna dhe preparate medicinale;
Themelues i Fondacionit *Ibrahim Kodra*, Lugano;
2000-2004 – Mbështetje për ngritjen e infrastrukturës së TMK-së në Prishtinë dhe kontribut në pajisjet profesionale të saj;
2005 – Mbështetje për ngritjen e Qendrës memoriale në Penuhë të Podujeves;
2004 – Ndërmjetësimi dhe lirimi i pengjeve në Afganistan (pas një qëndrimi trejavor me sukses arrin të lirojë tri pengjet, punëtorë të OKB-së, **Shqipe Hebibit, Annete Flaninghan dhe Angjilito Najan**;
2006 – Ndërmjetësimi dhe lirimi i gazetarit të marrë peng në Afganistan, Gabrielle Torsello;
2006 – Fondacioni *Behgjet Pacolli*, Prishtinë (bursa studimore, asistencë sociale për njerëzit në nevojë, ndërtimi i shtëpive për skamnorët dhe kontribute tjera në jetën sociale dhe kulturore);
2007 – Kontribut në ndërmjetësimin dhe lirimin e 23 pengjeve koreanë në Afganistan;
2008-2011 – Lobim permanent për njohjen e Republikës së Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran;

2007 – Projektues, sponsor dhe financues i gjithë infrastrukturës së Universitetit Amerikan në Kosovë AUK;

2009 – Financon ndërtimin e zgjerimit të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës;

2008 – Financon projektin e rindërtimit dhe restaurimit të xhamisë së Llapit në Prishtinë (objekt në kuadër të trashëgimisë kulturore të Kosovës);¹

Sponsorizues i sportit dhe kulturës në Kosovë;

Kontribut tërësor në ndërtimin e strehimoreve dhe shtëpive për familjet skamnore; (*në vazhdim e sipër*)

Asistencë në dërgimin për shërim jashtë vendit të dhjetëra pacientëve në vit; (*në vazhdim e sipër*)

Asistencë sociale invalidëve dhe personave në nevojë (pagë mujore); (*në vazhdim e sipër*).

VEPRIMI DHE ANGAZHIMI POLITIK PROMOVUES DHE THEMELUES

1999 – FORK – *Fondacioni për Rindërtimin e Kosovës*, Prishtinë;

2000 – Themelues i UASH, *Unioni i Afaristëve Shqiptarë*, Lugano;

2004 – Themelues i SEED, *Fondacioni për zhvillim ekonomik të Evropës Juglindore*, Uashington (Fondacioni promovues dhe lobues i pavarësisë së Kosovës);

2005 – Themelues i organizatës *New Kosova Alliance*, Uashington (organizatë lobuese për pavarësinë e Kosovës, 2005-2007);

2006 – Themelues dhe Kryetar i Partisë Politike *Aleanca Kosova e Re*, AKR (*parti politike që në zgjedhjet e para në vitin 2007, renditet si partia e tretë politike në vend*);

Anëtar i *Center for International and Strategic Studies CSIS* (Qendra për Studime Strategjike Ndërkombëtare), Uashington, Këshilltar permanent i Komitetit të udhëhequr nga Henry Kissinger;

2007-2010 – Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës;

2011 – Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës (mandati i dytë);

2011 – PRESIDENTI i Republikës së Kosovës;²

2011 – Inicues dhe nënshkrues i marrëveshjes së koncensusit politik për reformat kushtetuese dhe zgjedhore;

2011 – ZËVENDËSKRYEMINISTËR I PARË i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përgjegjës për politikën e jashtme dhe investimet e huaja;

2012 – THEMELUES i Lëvizjes për Unionin Ekonomik Shqiptar, së bashku me ish Presidentët e Shqipërisë, Rexhep Meidani dhe Alfred Moisiu, Rektorë Universitetesh, personalitete të shquara nga gjithë hapsira shqiptare.

VLERËSIME:

Dekoratat e TMK;

Vlerësime dhe tituj nderi nga Universiteti i Teknologjisë së Roçester (Rochester);

Dekorata nga AUK (Universiteti Amerikan në Kosovë);

Dekoratat e larta të Shtetit të Perusë, Presidentit të Perusë;

Dekorata më e lartë shtetërore e Federatës Ruse (vlerësimet në arkitekturë), qytetari i dytë i huaj pas amerikanit Armand Hammer që e merr këtë dekoratë;

Qytetar nderi i Astanës, Republika e Kazakistanit;

Konsull nderi global i Liberisë (2002-2008);

Ambasador i Paqes (Universal Peace Federation);

Kalorës i Paqes Globale i Mijëvjeçarit; dhënë nga Centro Internazionale per la Pace fra i Popoli (Qendra Ndërkombëtare për paqen mes popujve) çmim i dhënë dhe Michail Gorbaciov, Perez De Cuellar, S.S. Giovanni Paolo II, Luciano Pavarotti, Helmut Kohl, Nënë Tereza e Kalkutës, Kofi Annan, Bill Gates, etj;

Mirënjohja nga Fondacioni Nelson Mandela;

Mirënjohja nga Fondacioni Clinton Global Initiative;

Qytetar nderi i qytetit të Lezhës – Shqipëri;

Titulli Doctor Honoris Causa nga Universiteti European i Tiranës;

Nderohet me “Çelësin e Tiranës”;

2011 – *Qytetar nderi i Korçës, Shqipëri;*

2011 – *Laureat i Gusi Peace Prize International* – në Manila, Filipine;

2012 – *Kryeqytetar dhe qytetar nderi i Baton Rouge, Shteti i Luizianes, SHBA;*

2012 – *Çelsi i Qytetit i New Orleans, Shteti i Luizianës, SHBA;*

2012 – *Medalje nderi e kancelarit të Community College në Baton Rouge, Luiziana.*

GJUHËT:

Gjuhë amtare: Shqip

Gjuhë të huaja: Anglishte, Frengjishte, Gjermanishte, Italishte, Rusishte, Spanjishte, Sërbo-Kroate, etj.

PUBLIKIMET:

Publikime të ndryshme nga sfera socio-ekonomike, politike dhe kulturore;

Themelues dhe botues i revistës “**Albanica**”;

Themelues i gazetës ditore “Lajm”;

Autor i librit autobiografik “Nga sfida në sfidë, Jeta Behgjet Pacolli, **2010**;

Autor “Bashkimi nis nga ekonomia”, përmbledhje referimesh dhe studimesh autorësh të ndryshëm mbi Hapësirën Ekonomike shqiptare.

SI LINDI AKR?

Gazetta Shkodra 11.10.2005

C'ashte Organizata Amerikane "Aleanca Per Nji Kosove Te Re" *Sami Repishti*

www.newkosovo.org

Baldwin, N.Y. 11 tetor 2005.- Me 10 tetor 2005, ditën e hane, një grup personalitetesh diplomatike amerikane, i kryesuem nga Ambasadori William Walker, mbajti një Konferencë shtypi në Prishtinë, Kosova e Lirë, dhe deklaroi publikisht formimin e një organizate amerikane të posaformueme, me emrin "Aleanca për një Kosovë të Re" (The Alliance for a New Kosovo) me qendër në Washington, D.C. Kjo organizatë përfshinë një grupullim ish-diplomatësh, dhe personalitetësh tjerë politikë dhe akademikë amerikane. Gjatë kësaj vizite, miqtë amerikanë paraqitën disa pikepamje që reflektojnë esencën e mendimit që drejton veprimtarinë e grupit të ri.

"Grupi 'Aleanca për një Kosovë të Re' ashtë formë me qëllim që të avancojë zhvillimin e ngjarjeve këtu në Kosovë." tha Ambasadori Walker. Ai denoi konceptin e "pavaresisë së kushtezueme" (conditional independence) si "absurd", sepse nuk e zgjidh problemin e Kosovës thellësisht. Simbas tij, sot ashtë koha e duhur të shpejtohet zhvillimi i ngjarjeve në Kosovë, me që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, e ka pranuar se tani ashtë koha për bisedime që duhet të përcaktojnë statusin final të Kosovës. Z. Annan erdhi në këtë thellësim mbasi lexoi dhe shqyrtoi Raportin komprehensiv mbi gjendjen në Kosovë të paraqitur nga përfaqësuesi i tij, Ambasadori Kai Eide.

"Pavaresia e kushtezueme për Kosovën," tha Ambasadori Walker, "mendoj se ashtë një rrugë e papershtateshme për t'iu qasë statusit (final), mbasi na kemi fjalën për një status thellësimtar, dhe jo për një pavaresi të kushtezueme, që për mendimin tim, nuk ashtë status thellësimtar."

Anëtarët tjerë të delegacionit u solidarizuan me një qëndrim të ketill, dhe kërkuan haptazi një pavaresi dhe një sovranitet të plotë për Kosovën. Gjenerali Robert Gard (U.S. Army, Ret.) tha se: "Me sa di unë, Grupi i Kontaktit ka dalë me qëndrimin se nuk do të ketë coptim të Kosovës, dhe as bashkim me ndonjë vend tjetër. Ateherë, çka mbetet këtu përvec pavaresisë?" pyeti ai.

Për pikësynimet e organizatës së posaformueme, diplomati veteran amerikan, Sam Hoskinson spjegoi se "... 'Aleanca për një Kosovë të Re' nuk ashtë një organizatë qeveritare, dhe nuk ashtë formë me qëllim përfitimi të çfarëdo lloji qofte. Qëllimi i sajë ashtë të përqendrojnë vëmendjen e bashkësisë nderkombetare mbi Kosovën, dhe të sigurojë një zgjidhje të shpejtë e të drejtë të statusit të Kosovës." Z. Huskinson shtoi se "... ekziston edhe vizioni ekonomik përfitimtar të pavaresisë së Kosovës" që do të ishte i dobishëm edhe për rajonin. "Duhet shikuar ideja e një zone të përbashkët ekonomike për të gjithë rajonin (e Ballkanit), për Kosovën dhe fqinjët e saj, në mënyrë që të ketë një treg të përbashkët (a common market)" tha ai.

Përfaqësueset e grupit "Aleanca..." njoftuan publikisht se kanë kontakte me Qeverinë e Kosovës, si dhe me Administratën e Presidentit George W. Bush, dhe qeveritë tjera europiane .

C'ashte "Aleanca për një Kosovë të Re"?

Organizata "Aleanca për një Kosovë të Re" ashtë formë zyrtarisht me datën 31 gusht 2005, dhe regjistruar si "korporatë" me qeverinë amerikane ("under the Non-Profit Corporation Act – D.C. Code 2001 Edition, Title 29, Chapters, as Amended") Kjo organizatë do të jetë "...një organizatë e pavarur, jo-partiake, dhe transparente, një organizatë jo-qeveritare e përbërë nga individë kosovarë dhe amerikanë të interesueme (për fatin e Kosovës), dhe të gjithë të bashkueme nga dëshira e tyre me ndërtuar një të ardhme për Kosovën, e mbështetur mbi vlerat e një qeverisjeje të hapur, tërëqetë të lirë, demokraci, dhe përgjegjësi (accountability)..."

Me qellim te organizimit te punes u zgjodh si drejtor ekzekutiv Z. Kempton B. Jenkins, nji veteran diplomat me eksperince tridhjete vjecare. Z, Jenkins do te ndihmohet ne punen e tij nga nji Keshille Konsultativ (Advisory Board) me keto persona:

The Honorable Robert Carr, ish deputet, Dhoma e Perfaqesuesve te Kongresit Amerikan

Lt.General Robert Gard (U.S Army-ret.) ish President, National Defense University

Jacqueline Grapin, President, European Institute

Bobby Muller, President, Vietnam Veterans of America Foundation

Prof. Sami Repishti, Adelphi U.-ret, b/autor i "Studies on Kosova"

Ambasador William Ryerson, ish U.S. Ambasador to Albania

Ambasador Walter Stadler, ish Keshilltar per Europen, USUN; N/President, National Defense University

Ambasador William Walker, ish perfaqesues special i OKB-se per Slavonine Lindore, Kroacine, dhe leader i Misionit te Verifikimit ne Kosove.

Per informimin e publikut te gjane, ashte vendose botimi periodik i nji Buletini me titull "*Kosovo Notes and Comments*" Numri i pare i ketij organi, u botue me 1 tetor 2005, ne Washington D.C. (editor Mr. Mark Perry). Per arritjen e nji audience sa ma te gjane, organizata e re ka edhe website-in e saje: www.newkosovo.org

Ne numrin e pare te Buletinit organizatoret spjegojne:

" Na punojme cdo dite per nji Republike te Kosoves e cila do te jete nji pjese integrale e Europes dhe e institucionve trasatlantike, nji Kosove qe do te permbushet angazhimet e marruna per paqen nderkombetare dhe drejtesine, dhe qe do te plotesoje nevojet e te gjithe popullsisë saje. "Aleanca per Nji Kosove te Re" ka besim ne krijimin e nji Republike te Kosoves qe respekton te drejtat e te gjithe popullit te saje pa perjashtim, dhe pavaresisht nga raca, ngjyra, besimi, ose perkatesia kombetare." Ky "besim" i Aleances..mbeshtetet ne sukseset e arrijtuna deri sot ne Kosove. Faktet tregojne se Kosova ashte e pjekun politikisht per pavaresi te plote. Keto fakte jane:

- Ashte ba perparim i dukshem ne te gjitha aspektet per permbushjen e standardeve te kerkueme nga Keshilli i Sigurimit i OKB-se.
- Ekziston nji perkraheje e gjane nderkombetare per pavaresine e Kosoves.
- Ekziston mendimi i pergjithshem se gjendja e tanishme ashte njikohesisht e padeshirueshme dhe e paqendrueshme.
- Gjate ketyne viteve jane krijuar institucione te perfaqesimit popullor, tue perfshi Presidencen, Parlamentin, Qeverine qendrore, pushtetin lokal, dhe partite politike:
 - Jane ba perpjekje me lehtesue kethimin e refugjateve serbe, e tjere.
 - Jane hjedhe bazat e nji ekonomie funksionale te tregut
 - Ashte hape dialogu me partite politike serbe, megjithese jo i plote
 - Jane institucionalizue organet e sherbimit te sigurimit
 - Nji polici e pavarun siguron jeten dhe pasunine e qytetareve
 - Mass-media ashte e lire, dhe mbrohet nga nderhymja qeveritare
 - Ashte krijuar pjeserisht sistemi gjyqsor qe vepron simbas ligjeve ne fuqi.

- Dhe mbi te gjitha, Kosova ka mbajte zgjedhje , lokale dhe republikane, ne nji amosfere entuziasmi popullor, plotesisht te lira dhe te drejta, ("free and fair") nji fenomen qe ka terheqe vemendjen e bashkesise nderkombetare.

"Aleanca per nji Kosove te Re" mendon se:'

A) "Ne rrethana shume te veshtira, populli i Kosoves ka punue se bashku ne ndertimin e nji shoqenie te re, te percaktueme nga standardet (e OKB-se)"

B) "Agjensi te pavaruna, qeveri, dhe organizata nderkombetare jo-qeveritare kane arrijte ne perfundimin se mjeti ma i mire dhe ma i besueshem me sigurie qe Kosova te plotesoje standardet e caktueme nga OKB-ja ashte dhanja e pavaresise se Kosoves."

C) "Nji protektorat i vazhdueshem i OKB-se mbi Kosoven, ne fakt ka ashpersue ndasite e mbrendshme te ketij shteti qe po linde, ndersa ne zonat ku OKB-ja nuk ka ndonji rol,- organizatat lokale, krahinore dhe kombetare- po ndertojne institucione civile qe jane te pavaruna, te hapuna per te gjitha, dhe transparente."

D) "Sot ashte nji rast unik qe duhet shfrytezue.... Kosova paraqet nji rast unik per SHBA-n dhe BE qe te vendosin nji shtet te hapun per te gjitha, te lire, demokratik dhe te qendrueshem ne zemer te Europes.jug-lindore- dhe te perfundoje misionin e bashkesise nderkombetare qe u fillue ne vitin 1998." Aleanca...mendon gjithashtu se "...formimi i nji shteti laik me shumice myslimane, tolerant i te gjitha popullsive etnike pavaresisht nga bindjet e tyne fetare personale, do te shikohet si nji fitore per vlerat kombetare qe mbrohen nga SHBA, dhe vendet e Bashkimit Europian."

Nji shtet i ketill do te ishte nji shembull i ndritun per shume vende tjera islamike.

Aleanca"*...I ban thirrje bashkesise nderkombetare qe te vendose me besim fatin e Kosoves ne duert e popullit te Kosoves. Ka ardhe koha te njihet pavaresia e Kosoves, dhe te fillohet puna e gjate, por e nevojshme, per ndertimin e nji shoqenie qe pranon respek-timin e vlerave (te botes se qytetnueme)".*


Aleanca...perkrahe deklaraten e 6 shtatorit 2005 te Senatorit Robert Dole, te bame ne Darken Vjetore te KKSNA-NAAC, (organizata ma efektive dhe me kredibilitet te plote prane organizatave federale amerikane)

" Nderhymja ushtarake e udhehequn nga SHBA vuni Kosoven ne rrugen e lirise, por ka qene nji udhetim i ngadalshem. Keto gjashte vitet e fundit, Kosova ka qene nen administrimin e OKB-se. Me perjashtim te disa rasteve te vecanta, rendi publik ashte stabilizue. Nen drejtimin e OKB-se Kosova ka krijue institucionet e reja te qeverise dhe shoqenise civile. Sot, Kosova ka strukturen dhe mekanizmin e plote me funksionue si shtet modern, si dhe mjetet me zhvillue tregun e lire, dhe ma ne fund me gezue andrren e saje per liri dhe prosperitet."


Veprimtaria e pare publike e Aleances...do te zhvillohet me mbajtjen e nji Konference "Kosova dhe Statusi Perfundimtar" qe do te mbahet ne sallat prestigjioze te Metropolitan Club, ne Washington,D.C. me daten 27 tetor 1995. Nji "Concept Paper" mbi kete Konference jep keto te dhana:

Objektivet.-

1. Me krijue nji amosfere serioze per komente mbi Raportin e OKB-se me perqendrim ne pavaresi, dhe me paraqitje te thukeshme te argumenteve ekonomike qe imponojne pavaresine.
2. Me bashkue ne nji tryeze nji bashkesi me interesa te perbashketa per nji sinergji maksimale, vecanerisht bashkesine ekonomi/afarizem.



Me Ana Oxa-në dhe ish kandidatin për President të SHBA-ve, Bob Dole.



Zëvendës Presidenti amerikan Biden gjatë një vizite në Kosovë

KOMPANIA QË LOBOI PËR KOSOVËN

Ç'ËSHTË JEFFERSON WATERMAN INTERNATIONAL?

Prej më shumë se 15 vjetësh, Jefferson Waterman International ka përfaqësuar qeveri, interesa politike dhe korporata ndërkombëtare nga më të mëdhatë, duke i ndihmuar në arritjen e objektivave të tyre në SHBA dhe në të gjithë botën. Praktika e JWI është ekskluzivisht ndërkombëtare, me ekspertizë të veçantë në çështje që lidhen me zhvillimin e kombeve. Efektiviteti i JWI-së buron prej përvojës së pasur dhe lidhjeve globale të njerëzve që e përbëjnë: internacionalistë të shquar nga komunitete të inteligjencës së SHBA-së, si dhe nga biznesi, siguria, marrëdhëniet qeveritare dhe me medien. Këto individualitete përdorin me mençuri njohuritë e tyre mbi çështjet, proceset, dhe vendimmarrësit në funksion të ekzekutimit të strategjive që përmbushin qëllimet e klientëve.

Jefferson Waterman International është firma kryesore në ofrimin e shërbimeve politike dhe të këshillimit mbi biznesin, me seli në Uashington, D.C., SHBA; me klientë kryesorë subjekte politike (qeveri sovraane, parti dhe lëvizje politike, dhe organizata me qëllim të përcaktuar), si dhe korporata ndërkombëtare (kompani që hyjnë ose zhvillojnë tregje të reja, apo që kërkojnë mbështetje me investime).

Njerëzit e JWI ofrojnë një mori kontaktesh dhe njohurish të zhvilluara përgjatë dekadave me shërbim të rangut të lartë në inteligjencën amerikane, marrëdhënie qeveritare, agjenci sigurimi, etj. Ekspertiza e tyre, lidhjet e jashtëzakonshme dhe të kuptuarit e thellë të çështjeve dhe kulturave mbarëbotërisht, përkthehen në rezultate.

DISA NGA PROFILET E NJERËZVE MË TË RËNDËSISHËM TË JWI:

Çarls Uotërmen (Charles Waterman) është Shefi Ekzekutiv dhe anëtar themelues i JWI. Experienca dhjetërvjeçare e Z. Waterman në arenën ndërkombëtare përkthehet në një aftësi të jashtëzakontë në krijimin e mjediseve politike të favorshme për sipërmarrjet politike dhe tregtare të klientëve. Përpara themelimit të JWI, ai ka mbajtur disa pozicione drejtuese në shërbimin inteligjent amerikan, CIA (U.S. Central Intelligence Agency), si zëvendëskryetar i Këshillit Informativ Kombëtar, etj. Zotit Waterman i janë akorduar dy çmime: Ylli dhe Medalja e Inteligjencës së CIA-s dhe Zyrtar i Merituar i CIA-s. Z. Waterman është diplomuar në Universitetin e Braunit (Brown University), në Rhode Island dhe ka kryer një specializim në Shkollën e Studimeve të Përparuara Ndërkombëtare në Uashington, D.C., për Lindjen e Mesme. Gjithashtu, ishte përfutuesi i një burse për rezultate të shkëlqyera akademike. Ai flet arabisht dhe frëngjisht.

Samuel M. Hoskinson, është Zëvendëspresident Ekzekutiv i JWI. Ai drejton programe të përkrahjes politike ndërkombëtare dhe të depërtimit në tregun e shitjes, duke mbartur mbi vete dekada përvojë në të dy sektorët, publik e privat dhe rrjetin e lidhjeve me njerëz të rëndësishëm në komunitetin ndërkombëtar. Z. Hoskinson ka mbajtur detyrën e zëvendëskryetarit të Këshillit Informativ Shtetëror, atë të Zëvendësnësekretarit për Politikën Ekonomike në Departamentin e Shtetit, në administratën e George H.W. Bush, etj. Ai ka shërbyer nën tre këshilltarë të sigurisë kombëtare- Henry Kissinger, Brent Scowcroft, dhe Zbigniew Brzezinski-kur ishte anëtar i lartë i Staffit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë. Në sektorin privat, Z. Hoskinson ka qenë manaxher për strategjinë ndërkombëtare të korporatës pranë Bechtel Group. Ai ka marrë disa nderime si Medalja Kombëtare Inteligjente e Arritjeve për shërbimin e tij në komunitetin e inteligjencës, etj. Z. Hoskinson është diplomuar në Universitetin e Iowa-s. dhe ka kryer studimet master në Universitetin e Georgetown-it, në Uashington, D.C.

Ken Yates, Zëvendës President për Marrëdhëniet Publike

Si Zv. President për Jefferson Waterman International, Ken Yates manaxhon shërbimet e marrëdhënieve publike të JWI-së duke përfshirë zhvillimin dhe koordinimin e strategjive globale të marrëdhënieve publike për qeveritë, medien, dhe vendimmarrësit ndërkombëtarë. Ai zhvillon materiale mbi komunikimin, ekspozimin mediatik dhe evente mbi punët publike.

Z. Yates ka më tepër se tri dekada përvojë ndërkombëtare në çështje të marrëdhënieve me medien dhe punëve publike, veçanërisht në Azinë Lindore. Në tri dekada si Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm në Departamentin e Shtetit dhe në Agjencinë e Informimit të SHBA-së, ka qenë arkitekti parësor i programimit të komunikimit dhe të punëve publike. Ka shërbyer si përfaqësues diplomatik dhe negociator për Departamentin e Shtetit. Ai është diplomuar në Universitetin e Pensilvanisë dhe në George Washington University in Uashington, DC. Ai flet disa gjuhë të huaja, ndër to edhe pak kinezishte.

Samuel Wyman, Zëvendëskryetar dhe Shef i Operacioneve

Ambasadori Jackson McDonald, President

Joseph W. Augustyn, Zëvendëspresident Ekzekutiv për Sigurinë dhe Informimin.



Me kongresmenin Eliot Engel

The Washington Post

New Course For Kosovo

Advertisement



Rice Makes Her Presence Felt

By Richard Holbrooke
Wednesday, April 20, 2005

Significant differences between the first and second Bush terms continue to emerge. After studied silence in her White House years, Secretary of State Condoleezza Rice is beginning to reveal her style and values, clearly with presidential approval. She seems to be a pragmatic conservative, oriented toward problem-solving, pursuing essentially non-ideological policies. She is careful (and politically smart) to keep faith, in all her statements, with neoconservative values, but she is also finding high-profile, low-cost ways, such as extensive travel, to improve America's shaky image and relationships around the world. Several recent events are worth attention:

? The dramatic policy reversal -- personally shaped by President Bush -- resulting in a decision not to veto a U.N. Security Council resolution authorizing a role for the International Criminal Court in Darfur. This was the first time in four years that the Bush administration had departed from its practice of opposing anything having to do with the ICC.

? Deputy Secretary of State Robert Zoellick's well-orchestrated trip to Sudan, following the U.N. vote, to hammer the Khartoum government on Darfur. Zoellick became the first U.S. official to embrace the suggestion of several people, including U.N. Secretary General Kofi Annan and Sens. Hillary Rodham Clinton and Jon Corzine, that NATO could play a role in support of an African Union peacekeeping force. (Next: Appoint a high-level special envoy for Darfur and a separate, full-time ambassador accredited to the African Union.)

? The appointment of outgoing World Bank president James Wolfensohn to the new post of special coordinator for development of Gaza -- an inspired choice, given Wolfensohn's reputation in this field; also a rather bold one for an administration that has famously subjected its appointees to a political litmus test

KURS I RI PËR KOSOVËN

NGA RICHARD HOLBROOKE - I DËRGUARI PRESIDENCIAL PËR BOSNJËN DHE KOSOVËN NË ADMINISTRATËN KLINTON, SHKRIM I BOTUAR NË GAZETËN "THE WASHINGTON POST"

20 prill 2005 - Dallime të mëdha mes mandatit të parë dhe të dytë të Bushit vazhdojnë të shfaqen. Pas një heshtjeje të mirëmenduar në vitet e saj në Shtëpinë së Bardhë, Sekretarja e Shtetit Condoleezza Rice ka filluar të zbulojë stilin dhe vlerat e saj, qartësisht me miratimin e Presidentit. Ngjason si një konservatore pragmatike, e orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, duke ndjekur thelbësisht politika joideologjike. Ajo është e kujdesshme (dhe politikisht e zgjuar) në mbajtjen e fjalës, në të gjitha deklaratat e saj, me vlera neokonservatore, por ajo po gjen gjithashtu rrugë të një profili të lartë, me kosto të ulët, si udhëtimet e shpeshta, për përmirësimin e imazhit dhe marrëdhëniet të lëkundura të Amerikës në të gjithë botën.

.....Një ndryshim i dukshëm i politikës ka shkuar pa u vënë re lidhur me çështjen e Kosovës, ku, pas katër viteve të neglizhencës dhe gabimeve, Administrata ka bërë një ndryshim të madh. Që pas fushatës 78-ditore të bombardimeve të NATO-s, shqiptarët e Kosovës u çliruan nga kthetrat shtypëse të Slllo-bodan Millosheviçit dhe prej vitit 1999, kontrolli politik i Kosovës ka qenë në duart gjysmë-kompetente të Kombeve të Bashkuara, ndërkohë që NATO ka ruajtur paqen e brishtë në mes shumicës shqiptare dhe minoritetit serb. Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, e miratuar në vitin 1999, statusi përfundimtar i Kosovës, i cili supozohet të jetë përpunuar përmes negociatave, do të rezultojë ose pavarësi, ose ndarje e Kosovës, si ish pjesë e një vendi të njohur dikur si Jugosllavia, tani "Sërbia dhe Mali i Zi". Uashingtoni dhe Bashkimi Evropian prodhuan një politikë të quajtur "standartet para statusit", një frazë që ka maskuar mosveprimin burokratik diplomatik. Si rezultat, nuk ka pasur diskutime serioze mbi të ardhmen e Kosovës për katër vitet e fundit. Së fundi, trazirat e përgjakshme të marsit shkaktuan vdekjen e 11 shqiptarëve dhe 8 serbëve, një mijë njerëz të plagosur dhe një rajon të tensionuar.



Richard Holbrooke dhe Gjenerali W. Clark

that the liberal Wolfensohn, a Bill Clinton appointee, could never have passed.

One notable policy change has gone virtually unnoticed -- the one concerning Kosovo, where, after four years of neglect and mistakes, the administration has made a major shift. Ever since the 78-day NATO bombing campaign freed the Kosovar Albanians from Slobodan Milosevic's oppressive grip in 1999, political control of Kosovo has been in the semi-competent hands of the United Nations, while NATO has maintained a fragile peace between the majority Albanian and minority Serb populations.

Under Security Council Resolution 1244, passed in 1999, the final status of Kosovo was supposed to be worked out through negotiations that would result in either independence, partition or a return by Kosovo to its former status as part of a country once known as Yugoslavia, now "Serbia and Montenegro." But instead of starting this process years ago, Washington and the European Union fashioned a delaying policy they called "standards before status," a phrase that disguised bureaucratic inaction inside diplomatic mumbo-jumbo. As a result, there have been no serious discussions on the future of Kosovo for the past four years, even as windows of opportunity closed and Albanian-Serb tensions rose. Finally, bloody rioting erupted last March, leaving eight Serbs and 11 Albanians dead, a thousand people injured and the region teetering on the brink of another war. Tensions have remained high ever since; just two days ago there was a bomb attack on the offices of an opposition party in Kosovo.

Last month, after warnings about the explosiveness of the situation from Philip Goldberg, America's senior diplomat there, Rice sent Undersecretary of State Nicholas Burns to Europe for meetings with the nearly moribund Contact Group (the United States, Britain, France, Italy, Russia and Germany). Burns told them that the situation in Kosovo was inherently unstable and, unless there was an acceleration of efforts to determine its final status, violence would probably increase, with NATO forces, including U.S. troops, tied down indefinitely.

Under American pressure -- always the necessary ingredient in dealing with the sluggish, process-driven European Union -- a new Contact Group policy has begun to emerge. This summer a special U.N. representative will "determine" that Kosovo has met the necessary standards -- self-governance, refugees, returnees, freedom of movement, etc. -- and is therefore ready for status talks. (Of course, this should have been done years ago, but better late than never.) Then will come the really tough part: What should Kosovo's final status be? Separate nation, Serb province, partition?



Richard Holbrooke dhe Hillary Clinton

Muajin e kaluar, pas paralajmërimeve nga Philip Goldberg, diplomat i lartë amerikan atje, Rice ka dërguar Nënsekretarin e Shtetit, Nicholas Burns, për takime me Grupin e Kontaktit që gati po perëndon (Shtetet e Bashkuara, Britania, Franca, Italia, Rusia dhe Gjermania). Burns bëri të ditur situatën në Kosovë, e cila ishte e paqëndrueshme në mënyrë inhereente dhe nëse zgjidhja e statusit final nuk do përshpejtohej, dhuna do të rritej me gjasë, me forcat e NATO-s, duke përfshirë trupat amerikane, që do të rrinin me duart lidhur përfundimisht.

Nën presionin amerikan, gjithmonë përbërës i nevojshëm në trajtimin e proceseve të ngadalshme të udhëhequra nga BE, Grupi i Kontaktit ka filluar të shfaqë një politikë të re. Këtë verë, një përfaqësues special i OKB, do të “përcaktojë” nëse Kosova ka standardet e nevojshme për vetëqeverisjen, refugjatët, të kthyerit, lirinë e lëvizjes, etj., dhe për këtë arsye është e gatshme për bisedimet e statusit. (sigurisht kjo do të ishte bërë më mirë disa vite më parë, por më mirë vonë se kurrë). Pastaj do të vijë pjesa më e vështirë: Cili duhet të jetë statusi përfundimtar i Kosovës? Shtet i veçantë, provincë serbe, ndarje?

Edhe pse askush nuk është duke folur me zë të lartë në Uashington apo në Evropë, unë e shoh të vështirë ndonjë rezultat përfundimtar për Kosovën, përveç pavarësisë, ndoshta në mënyrë të shkallëzuar në pak vitet që do të pasojnë. Por një rezultat i tillë do të kërkonte garanci të forta për mbrojtjen e pakicës serbe-midis 100 mijë dhe 200 mijë vetëve. Mbrojtja e serbëve të Kosovës do të kërkojë një lloj pranie ndërkombëtare të vazhdueshme. Përveç kësaj, shqiptarët e Kosovës, të ndarë thellësisht, kryeministri i të cilëve po përballet me akuzën për krime lufte në Hagë duhet të arrijnë një nivel më të lartë të pjekurisë politike.

Në fund të fundit, Beogradi do të duhet të pranojë diçka politikisht të vështirë: duhet të heqë dorë nga pretendimet serbe në Kosovë, të cilën serbët e konsiderojnë si djep i tyre historik. Serbët do të përpiqen të zgjedhin dy alternativa, të përpiqen për t’u bashkuar me Bashkimin Evropian apo për të rifituar Kosovën. Nëse ata kërkojnë krahinën e tyre të humbur, nuk do arrijnë asgjë, por në qoftë se do të zgjedhin të ardhmen mbi të kaluarën, Serbia do të ketë një të ardhme të ndritshme si anëtare në BE, dhe ëndrra e lashtë për Evropë Juglindore të qetë dhe me një ekonomi të integruar (duke përfshirë Greqinë dhe Bosnjën) do

Although no one is talking on the record in Washington or in Europe, I find it hard to see any ultimate outcome for Kosovo other than independence, perhaps on a staged basis over the next several years. But such an outcome requires strong guarantees for the endangered Serb minority that remains in Kosovo -- between 100,000 and 200,000 people. The protection of Kosovo's Serbs will require some sort of continued international security presence. In addition, the deeply divided Kosovar Albanians, whose last prime minister is now facing war crimes charges in The Hague, must achieve a much higher level of political maturity.

Ultimately, Belgrade will have to accept something politically difficult: giving up Serbian claims to Kosovo, which Serbs regard as their historic heartland. The Serbs will have to choose between trying to join the European Union and trying to regain Kosovo. If they seek their lost province, they will end up with neither. But, if it can opt for the future over the past, Serbia would have a bright future as an E.U. member, and the ancient dream of an economically integrated, peaceful Southeast Europe (including Greece and Bosnia) would be within reach. The European Union, however, must make a real deal on Kosovo an integral part of the membership process for Serbia.

There are many complicated subplots here, involving Montenegro, Bosnia, Albania, the United Nations, the E.U. and NATO. But for now the important thing is that after ignoring the issue for four years, the administration is doing something in the Balkans, where nothing happens without U.S. leadership. Given that instability in the Balkans -- and Kosovo is highly unstable now -- has historically spread into other parts of Europe, and that the region lies in the heart of the growing NATO sphere, this is the sort of problem that must be addressed before it grows again into a major crisis.

Richard Holbrooke, a presidential envoy for Bosnia and Kosovo during the Clinton administration, writes a monthly column for The Post.

© 2005 The Washington Post Company

të ishte plotësisht e realizueshme. Bashkimi Evropian duhet të bëjë një marrëveshje reale për Kosovën si pjesë integrale e procesit të anëtarësimit të Sërbisë.

Ka shumë nënkuptuj të komplikuar këtu, që përfshijnë Malin e Zi, Bosnjën, Shqipërinë, OKB-në, BE-në, dhe NATO-s. Por për tash, gjëja më e rëndësishme është se pasi kjo çështje është injoruar për 4 vjet, administrata është duke bërë diçka në Ballkan, ku asgjë nuk ndodh pa udhëheqësinë amerikane. Duke parë paqëndrueshmërinë në Ballkan- dhe Kosova është mjaft e paqëndrueshme tani- që përhapet në pjesë të tjera të Evropës dhe që rajoni gjendet në zemër të sferës në rritje të NATO-s, ky është një lloj problem që duhet të adresohet para se të rritet sërish në një krizë të madhe.¹



Me geostrategjistin, më të madh në botë, Zbignju Brzezinski (Zbigniew Brzezinski)

¹ Siç më ka treguar miku im Presidenti Meidani, diplomati i madh Hollbruk i kishte thënë jopublikisht që në 2001 gjatë një takimi në Shkup në një tubim të vendeve të Ballkanit, pas rënies së Milosheviqit se zgjidhja më e mirë për Kosovën do të ishte pavarësia. Por siç e pohon vetë Hollbruku në këtë artikull, apo dhe vëzhgues të rëndësishëm në Kosovë, dinamika e ngjarjeve në botë dhe në Kosovë, apo gabimet e vetë politikanëve kosovarë, bënë që ky opsion të humbte dukshmëri, ose të arkivohej përkohësisht. Ndaj këtu kuptohet rëndësia e punës së kompanisë që ne angazhuam. Shikoni muajin në të cilin është shkruar ky artikull : Hollbruk nuk ishte më pjesë e administratës amerikane të republikanëve, por si pjesë e demokratëve ai insistonte për vizionin e presidentit Clinton, i cili do duhej të ishte pavarësia për Kosovën.

From: Ken Yates

Sent: Tuesday, September 27, 2005 4:50 PM

To: 'ebiberaj@voanews.com'; 'axhixho@voanews.com'

Subject: American University in Kosovo new Campus Opening

Elez, after we last spoke on the phone, there have been several developments that bear on possible VOA arrangements to cover the opening of the new, Germia campus of the American University in Kosovo. Apologies for the delay in passing this information to you. The opening of the new campus is now scheduled for Monday, October 10th, about a week later than originally planned. I hope that this will not cause you scheduling difficulties.

Your principal contact in Kosovo should be Mr. Robert F. Curis, Director of the American University in Kosovo (+381-38-240-195, cell +377-44-503-925, rcuris@aukosovo.us. The school's website is at www.aukosovo.us.) Mr. Curis is handling all plans for the event.

At AUK, all instruction is in English, bridging the otherwise difficult problem of different languages used in Kosovo. The school is a major component of a new Kosovo and is affiliated with the Rochester Institute of Technology in Rochester, New York.

The ceremony at the Germia campus will begin at about 4:00 pm local time and will be moderated by Mr. Curis with brief remarks by President Rugova, the UN Special Representative of the Secretary General Soren Jessen-Petersen, the Chief of the US Office in Pristina Philip Goldberg and Chairman of the AUK Board of Directors, Amb. William Walker. Commemorative plaques will be awarded to Mr. Bukoshi and Mr. Pacolli who will follow with brief remarks. The ceremony should be complete by about 5:30 pm. Symbolic of the strong American commitment to the prosperous future of Kosovo, a delegation of distinguished Americans will travel to Pristina for the occasion. They include: former Congressman Robert Carr (D-Michigan), former US Army Lt. General Robert Gard, and others

Throughout the week there will be consultations and other meetings of the Kosovar and US members of the Board of Directors with faculty, staff and students of AUK. Arrangements for a TV crew to do outtakes of the new construction can be made directly with Mr. Curis.

A donation by Mr. Behgjet Pacolli, a businessman and President of Mabetex, made possible the rehabilitation of a site on the outskirts of Pristina. Next to Germia Park, the campus - including the six buildings that comprised the old Scholla Normale - will include modern classrooms, new computer labs, auditorium facilities and other attributes of a modern university. Rehabilitation began early in 2005 with more than 70 workers and material contributed by Mabetex.

We can assist you in scheduling an interview with Mr. Pacolli if that would be desired.

Please keep me informed of your plans.

Regards,

Ken Yates

29.09.2005

KEN YATES: “UNIVERSITETI AMERIKAN I KOSOVËS, VATËR ELITARE E PROMOVIMIT TË LIDHJEVE ME SHBA”

ZV/PRESIDENTI I WATERMAN, KEN YATES, NJOFTON NË 27 SHTATOR 2005 DREJTUESIT E SEKSIONIT SHQIP TË “ZËRIT TË AMERIKËS” PËR HAPJEN E UNIVERSITETIT AMERIKAN TË PRISHTINËS

Siç konfirmohet, që në vitin 2005, unë kisha ide të qarta për të arritur nëpërmjet ndërtimit të Universitetit Amerikan të Prishtinës, tek krijimi i një vatre elitare të arsimit të lartë. Kjo vatër do duhej të reflektonte tek cilësia e gjithë universiteteve të tjerë - kjo ishte ideja ime. Nëpërmjet këtij universiteti unë doja të promovoja lidhjet e mia dhe të Kosovës me politikanë me ndikim në SHBA.

Përfaqësuesi kryesor i Universitetit do të jetë Z. Robert F. Curis. Universiteti hapet në 10 tetor 2005. Në ceremoni marrin pjesë Presidenti Rugova, Përfaqësuesi special i Kombeve të Bashkuara, Petersen, shefi i Zyrës Amerikane, Goldberg dhe Ambasadori William Walker. Nga Amerika vijnë: kongresmeni Robert Kerr, Gjeneral-Lejtnant, Robert Gard etj. Donacionet u dhanë nga Behgjet Pacolli, President i Mabetex, i cili bëri të mundur realizimin e kompleksit modern të Universitetit, ku punuan më shumë se 70 punëtorë të Mabetex.

Nëse dëshironi, ne mund t'ju bëjmë të mundur realizimin e një interviste me z. Pacolli.



Me William Walker, ish-kryetarin e Prishtinës Ismet Beqirin në prerjen e shiritit të AUK-ut.

pascal najadi

Da: Samuel Hoskinson [SHoskinson@jwidc.com]
Inviato: mercoledì, 28. settembre 2005 18:27
A: Pascal Najadi
Oggetto: Media-American University in Kosovo new Campus Opening
Priorità: Alta

For you information!

-----Original Message-----

From: Ken Yates

Sent: Wednesday, September 28, 2005 11:50 AM

To: 'william_g_walker@yahoo.com'

Subject: FW: American University in Kosovo new Campus Opening

Amb. Walker: Jenks and I spoke today and agreed that you should receive a copy of the following message that was sent to the Voice of America Albanian service yesterday.

This morning I spoke with Mr. Vehbi Bajrami, just starting as the Chief of the Albanian Service this week. I suggested to Mr. Bajrami that they should speak with you, possibly on camera for their television feed, prior to your departure for the opening as a scene-setter. He said that he had your contact information and would be in touch with you.

I have since been in touch with Ms. Isabella Cocoli, an editor in the VOA Albanian Service, who also is working up a schedule for the event, so you may be hearing from her as well. It is particularly helpful that you are in Washington so that they may be able to get some on-camera actualities - possibly in their studios - to be used in video feeds to Kosovo and Albania. I hope that things will work to your convenience.

FYI, Greg Minjack, who will be in Kosovo for the opening to handle media and other arrangements, is working on the added possibility that EURONEWS will also cover the event along with VOA and local media. EURONEWS is a sort of an EU PBS/CSPAN that broadcasts via satellite services in seven languages in most of Europe.

Regards,

Ken Yates

Senior Vice President

Jefferson Waterman International

1401 K Street NW, Suite 400

Washington, DC 20005

202-216-2227 fax 202-216-2999

cell 202-413-1413 kyates@jwidc.com

-----Original Message-----

29.09.2005

KOMPANIA E PACOLLIT FAVORIZON KOSOVËN NË EURONEWS

MBULIMI MEDIATIK I KOSOVËS PËRHAPET EDHE NË EVROPË. ZËVENDËSPRESIDENTI I KOMPANISË LOBUESE WATERMAN, SAMUEL HOSKINSON, PËRCJELL KOMUNIKIMIN E ZV.PRESIDENTIT TË KOMPANISË, Z. YATES, PËR VENDOSJEN E KONTAKTEVE ME EURONEWS.

Kjo është një tjetër dëshmi e angazhimit të kompanisë sime në favor të Kosovës për mbulimin mediatik të hapjes së Universitetit Amerikan, në Euronews, në vitin 2005

Ambasadori Walker, Jenksi dhe unë folëm sot dhe ramë dakord që të marrësh një kopje të mesazhit drejtuar Zërit të Amerikës (VOA). Këtë mëngjes fola me Z. Vehbi Bajrami, i cili fillon këtë javë në pozicionin e shefit të Shërbimit Shqip. I sugjerova z. Bajrami që të flasë me ju mundësisht në kamera. Kam qenë në kontakt me Znj. Isabela Çoçoli, redaktore e Shërbimit Shqip në VOA, e cila është duke punuar për këtë ngjarje. Meqënëse ndodhesh në Uashington do jetë ndihmë e madhe të ofrosh disa imazhe aktualiteti në studion e tyre me pamje nga Kosova dhe Shqipëria. Greg Minjack do jetë në Kosovë dhe do e mbulojë ngjarjen për Euronews, sikurse edhe VOA bashkë me mediet lokale. Euronews është pjesë e EU PBS/CSPAN që transmeton në shtatë gjuhë, në shumë shtete të Evropës.



Gjatë një interviste ne VOA



Press Release

Pristina, Kosovo
October 10, 2005

Contact: Greg Minjack (202) 270-6465, or
Bekim Tahiri (044) 120-012

“Alliance For A New Kosovo” Delegation Visits Pristina

A delegation representing the Alliance for a New Kosovo visited Pristina on Monday, October 10, 2005 to participate in the inauguration of the expanded campus of the American University in Kosovo and to launch a campaign to achieve Kosovo’s independence at the conclusion of upcoming international status negotiations.

The delegation, including **Ambassador William G. Walker**, Lt. General **Robert Gard** (ret) and former U.S. Congressman **Bob Carr**, hosted a press conference on Monday, October 10, at the Grand Hotel, Pristina.

The Alliance distributed a White Paper urging the international community to “immediately and unconditionally begin a process that will lead to the full independence of Kosovo, leaving it to the people of Kosovo to make sovereign decisions regarding how to create a free, fair and open democratic society based on the rule of law with open markets and a robust civil society.”

In addition to the visiting delegates, other notable attendees, including **Behgjet Pacolli** and **Louis Sell**, Executive Director of the American University in Kosovo Foundation, came out to demonstrate support for mission of the Alliance.

“With the release of UN Special Representative **Eide**’s report, our efforts will be shifting into high gear” announced **Kempton Jenkins**, Executive Director of the Alliance.

për bashkëpunim intensiv, sepse kjo është rruga e vetme e daljes nga kriza dhe varfëria, rruga e vetme drejt paqes dhe përparimit dhe, poashtu, rruga e vetme drejt integriteteve perëndimore në komunitetin evropian.

Kjo mund të arrihet vetëm përmes vullnetit të përbashkët të mirë dhe tolerancës.

Sërish, iu drejtohem të gjithëve të kërkojmë mënyrën e drejtë për të ndihmuar përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare, në mënyrë që, me mirë heret se vonë, të gjithë fëmijët, femrat, të moshuarit dhe rinia

e rajonit tonë ta kenë të drejtën të jetojnë në paqe dhe stabilitet. Në një vend pa luftë, pa dhunë dhe pa frikë, në mënyrë që, të gjithë ne, të krijojmë një vend ku ka krenari, tolerancë, zhvillim ekonomik dhe drejtësi sociale.

Zonja dhe zotërinj, për gjithë këto e kam përpunuar planin, dhe vetëm më duhet bashkëpunimi dhe mbështetja juaj. I kam të përpunuara mirë këto plane, zonja dhe zotërinj, vetëm kërkoj bashkëpunimin dhe përkrahjen tuaj. Ju faleminderit shumë, zonja dhe zotërinj.

Fondacioni SEED, me seli në Lugano, që është pjesë e angazhimeve të biznesmenit kosovar Behgjet Pacolli, organizoi në Uashington të SHBA-ve konferencën "Integrimi dhe Kooperimi në Evropën Juglindore me Kosovën si shtet". Fjalën e hapjes e mbajti Z. Behgjet Pacolli.

Kosovën në këtë konferencë e përfaqësoi zëvendëskryeministri i Kosovës, Lutfi Haziri, dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bujar Dugolli.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të shumë shteteve të Evropës Juglindore dhe nga Stejt Departamenti Amerikan.

Ndër pjesëmarrësit e shumë veçohet prania e zyrtarëve nga Unioni Evropian, të Bankës Botërore, ministri i Ekonomisë i Sllovenisë, ai i Kroacisë, ministri i Punëve të Jashtme dhe ai i Ekonomisë i Malit të Zi. Ministri i Bosnje-Hercogovinës, Adnan Perziq, e kishte një fjalim mjaft pozitiv për Kosovën.

Në këtë konferencë nuk morën pjesë përfaqësuesit nga Shqipëria dhe Serbia, ndonëse ishin të ftuar.

Në fillim të dhjetorit do të mbahet një konferencë e ngjashme edhe në Kosovë.

WASHINGTON

Bexhet Pacolli: Pavarësia e Kosovës, çelësi i stabilitetit të rajonit SHBA, lobing për mbështetjen e aleatëve të saj në Ballkan

Washingtoni ka qenë dje qendra e zhvillimit të një aktiviteti të rëndësishëm për Ballkanin, ku kanë marrë pjesë zyrtarë të Departamentit të Shtetit të SHBA-së, si dhe personalitete të njohura të qarqeve vendimmarrëse amerikane. Bexhet Pacolli, themelues i Fondacionit për Zhvillimin Ekonomik të Evropës Juglindore, që ishte edhe një nga organizatorët e konferencës me temë "Bashkëpunimi ekonomik dhe mundësitë e investimeve në Evropën Juglindore", tha se pavarësia e Kosovës është çelësi i stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal. Kosova, tha ai, do të jetë një vend demokratik dhe i qytetaruar, ku të gjithë qytetarët e saj, pavarësisht nga përkatësia etnike, do të jetojnë në paqe. Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington, në bashkëpunim me Fondacionin për Zhvillimin Ekonomik të Evropës Juglindore dhe Institutin e Teknologjisë së Rochesterit, kanë organizuar një konferencë ndërkombëtare me temë "Bashkëpunimi ekonomik dhe mundësitë e investimeve në Evropën Juglindore" për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve



Bexhet Pacolli

te pazgjidhura të Ballkanit Perëndimor. Organizatorët kanë mbledhur një grup ekspertësh nga fusha të ndryshme, udhëheqës të biznesit nga Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe rajonit për të diskutuar mbi bashkëpunimin ekonomik dhe mundësitë e investimeve në Evropën Juglindore. Objektivi i konferencës është përshpejtimi i përpjekjeve të bashkërenduara të sektorëve shtetërorë dhe privatë për bashkëpunimin

Ballkani është një nga partnerët më besnikë në luftën globale kundër terrorizmit

dhe zhvillimin rajonal të Evropës Juglindore. Janush Bugajski, drejtor i projektit të Evropës Juglindore në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, tha se periudha e stabilitetit në vendet e Ballkanit përfundimor po afrohet fundit dhe këto shtete kanë tani përballë sfida të reja në aspektet e rindërtimit ekonomik dhe integritimit euroatlantik. Gjatë dekadës së ardhshme, tha ai, këto çështje do të kërkojnë një strategji transatlantike

afatgjatë dhe më gjithëpërfshirëse për tërheqjen e investimeve, nxirjen e ndërmarrjes private, hapjen e vendeve të punës dhe përmirësimin e standardeve të jetesës. Christoph Hoh, drejtori zyrtar për Evropën Juglindore në Departamentin Amerikan të Shtetit, tha se në dekadën e fundit rajoni i Ballkanit ka shënuar një përparim të ndjeshëm në spektrin politik, ekonomik dhe ushtarak. Ballkani është një partner strategjik dhe mik i Shteteve të Bashkuara dhe si i tillë është me shumë rëndësi që ai të bëhet pjesë e një Evrope të integruar, të lirë dhe paqësore. Zoti Hoh theksoi gjithashtu se Ballkani është një nga partnerët më besnikë të Amerikës në luftën globale kundër terrorizmit. Zyrtari i Departamentit Amerikan të Shtetit solli si shembull Shqipërinë si një rast të suksesshëm në fushën e reformës ushtarake. Por ai vuri në dukje se me gjithë arritjet e periudhës së pas-konfliktive të armatosura në Ballkan në një sërë fushash si ato politike, ekonomike dhe ushtarake, mbetet mjaft punë për t'u bërë për sa i përket shtetit ligjor, nëpërmjet zbatimit të normave juridike dhe forcimit të gjyqësorit.

Globus / Tetor 2006

JAVOR | standard | E SHITUNE 02.12.2006

3

INTERVISTË 23

INTERVISTA / Flet Kryetari i Partisë "Aleanca për Kosovën e Re", z. Behgjet Pacolli

PACOLLI NË POLITIKË Pak fjalë, shumë punë

Shteti në funksion dhe në shërbim të qytetarëve, sepse demokracia jeton nga pjesëmarrja e qytetarëve. Në të kundërt, liria e individit, shanset e barabarta, iniciativa e lirë, decentralizimi, privatizimi, prona private etj. etj., janë të rrezikuara

post. Angazhimi në politikë është një barë e madhe për mua. Unë jam rritur në perëndim. Kam punuar dhe punoj ne Zvicër. Jetoj familjarisht këtu, pra jam një qytetar i lirë. Kur dua të bëj një gjë nuk i marr leje kujt. Psh. nëse dua të udhëtoj në një pjesë tjetër, nuk keshillohem me askënd, udhëtoj kur të dua dhe kthehem kur të dua. Duse punuar këtu post, nëse populli i Kosovës do të vërtetë një gjë të tillë, unë marr mbi vete përgjegjësi të mëdha. Jam i gatshëm ta pranoj këtë post si borb ndaj popullit dhe Kosovës që i përka. Po të jetë për të qendruar në korrizat e mia personale kjo është një gjë, kurse posti i kryetarit të shtetit është tjetër gjë. Ai kërkon sakrificë dhe vullnet për t'u përballuar ato. Ky vullnet nuk më rringon. Me këtë rast unë do të kthehem përfundimisht në Kosovë.

astjherët nuk kanë qenë ato që kishim me ju përgjigj lokalitetit dhe nivelit të punimeve që unë kam dashur të kryej në Shqipëri. Në sektorin e projektimit të inxhinjerike ka ne punojnë kishim me i sjellë shumë doli Shqipërisë. Po ashtu, në fushën e investimeve inxhinjerike kemi mjaft me i sjellë shumë objekte Shqipërisë. Kam marrë pjesë në tendera, kam fituar, dhe pa më dhënë kurrfarë shpëgjimi më kanë larguar.

Pavarësisht nga këto raste që ju janë tënë shije të hidhur a kemi ndonjë projekt konkret për të investuar në Shqipëri, aq më shumë kur ka edhe një nënëm të kryeministrit shqiptar, "Shqipëria i Euro"?

E përshtesha çdo nënëm që mbështet biznesin dhe investimet e tua në Shqipëri. Ju më pyesin a kam plane komerciale? Po, kam. Është fjala për një in-



BEHGJET PACOLLI - Të lobosh për Kosovën

Standard / 12.12.2006

AKR-ja është prononcuar lidhur me Pakon e Ahtisarit

Brengos mospërmendja e pavarësisë

Prishtinë, 28 janar (ER) - Aleanca Kosova e Re, nëpërmjet një komunikate për media ka thënë se Plani i Ahtisarit, përkatësisht ato elemente të bëra publike, nuk i heqin paqartësitë lidhur më të ardhmen e statusit të Kosovës.

AKR-ja konsideron se brenda këtyre elementëve lihet hapësirë për interpretim pro dhe kundra pavarësisë së Kosovës.

"AKR mendon se pakoja e Ahtisarit do ta përmbajë një vlerësim të gjendjes aktuale në Kosovë dhe do ta propozojë një zgjidhje racionale, konform realitetit politik kosovar dhe ndërkombëtar, një zgjidhje që për momentin mund të jetë funksionale në rrethanat aktuale. Kjo do të thotë se propozimi do të jetë i favorshëm vetëm nga pikëpamja se ai do ta hapë perspektivën për krijimin e shtetit, nëse ne punojmë për ta bërë shtetin", thuhet në komunikatën e AKR-së.

Mospërmendja e fjalës pavarësi, thuhet në komunikatë, natyrisht se është brengosëse, aq më tepër kur tashmë nga zyrtarët e Kosovës është dëgjuar e përsëritur shumë shpesh. Ndërkaq, për të drejtat e propozuara për serbet, AKR-ja konsideron se janë përtej të gjitha standardeve të njohura ndërkombëtare, por mendon se edhe ashtu për të kaluar testin e demokracisë duhet ofruar perspektivë ekonomike që serbet e Kosovës të jetojnë, punojnë dhe mendojnë



për shtetin e Kosovës si shtet të tyre. "AKR e sheh veten si forcë vendimtare politike në procesin e krijimit dhe konsolidimit të shtetit të Kosovës. Ne si forcë e re politike kemi qenë të vetëdijshëm se sfida e statusit ka qenë dhe është e determinuar nga puna që është bërë dhe po bëhet për të krijuar institucione të qëndrueshme demokratike dhe shtet ligjor në Kosovë dhe jo nga deklaratat shumë optimiste që kanë dhënë dhe po japin zyrtarët tanë. Ne kemi qenë të shokuar kur dëgjonim deklaratat e papërgjegjshme të Grupit Negociator pas kthimit nga bisedimet e Vjenës se "fituam 8:2", në kohën kur Kosova duhej të bënte shumë më shumë punë konkrete në ndërtimin e shtetësisë

së saj faktike", thuhet në vazhdim të komunikatës.

Sidoqoftë, AKR mendon se Kosovës i mbetet të punojë brenda zgjidhjes që do t'i ofrohet nga Ahtisarit, duke shfrytëzuar maksimalisht hapësirën e dhënë për ta krijuar një Kosovë të hapur, me një ekonomi të zhvilluar, me raporte miqësore me vendet e rajonit dhe komunitetin ndërkombëtar. "Një Kosovë ku do të dominojë fryma e punës dhe e përmirësimit të standardit jetësor. Një Kosovë që ofron mirëqenie dhe barazi për të gjithë qytetarët e saj. Një Kosovë pa frikë, pa korrupsion dhe pa krim të organizuar. Një Kosovë ku secili do të ndjehej i sigurt për ardhmërinë e tij dhe pasardhësit e tij", thuhet në komunikatën e AKR-së.

DEKLARATË E KRYETARIT TË AKR-së, BEHGJET PACOLLIT, NË VIGJILJE TË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

PAVARËSIA ËSHTË DËSHMIA E PJEKURISË SONË PËR TA NDËRTUAR SHTETIN

Për Kosovën është me rëndësi pavarësig dhe fillimi i ndërtimit të shtetit të së drejtës, shtetit demokratik, multietik, multifetar dhe inkuadrimi i Kosovës në proceset integruese drejt shoqërive demokratike dhe të përparuara.

Prishtinë, 14 shkurt

Të nderuar qytetarë, anëtarë dhe simpatizantë të Aleancës Kosova e Re, Tani është afruar momenti historik për Kosovën, popullin e saj dhe po vihen themelet e ndërtimit të shtetit tonë.

Këto ditë pritet shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Ëshhtë shumë me rëndësi që këtë akt, përkatësisht momentin e deklarimit të saj, ta përjetojmë me pjekuri, dinjitet dhe pa eufori.


Për Kosovën është me rëndësi pavarësia dhe fillimi i ndërtimit të shtetit të së drejtës, shtetit demokratik, multietik, multifetar dhe inkuadrimi i Kosovës në proceset integruese drejt shoqërive demokratike dhe të përparuara.

Pavarësia e Kosovës nuk është befasi e rastit, por meritë që del nga një proces i gjatë, me shumë sakrificë dhe flitje.

Përpjekjet shekullore të Popullit të Kosovës për liri dhe e drejta për të jetuar i barabartë me të tjerët, tani po kurorëzohen me pavarësinë e shumëpritur. Për këtë ne, Aleanca Kosova e Re, u jemi mirënjohës të gjithë brezave që vepruan, e sidomos atyre që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre.

Ne u jemi mirënjohës të gjithë botës demokratike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Evropës dhe miqve tanë kudo në botë, që të drejtën tonë legjitime për pavarësi e mundësuan të bëhet realitet.

Miq të Kosovës, Organizata e Kombeve të Bashkuara me praninë e tyre në Kosovë, bashkë me organizatat e tjera qëveritare dhe joqeveritare, si dhe KFOR-in, mundësuan që Kosova të përgatitet në mënyrë të denjë për aktin e pavarësisë, për çka populli i Kosovës do t'u jetë mirënjohës gjithmonë. Aleanca Kosova e Re, duke falënderuar, dëshmon fuqishëm se të gjithë këta që përmendëm, mbeten pjesë e histo-



risë së lavdishme të Kosovës.

Qytetarë të nderuar, të tregojmë me maturi se pavarësia është dëshmia e pjekurisë sonë për ndërtim të shtetit.

T'i ikim provokimeve të mundshme dhe t'i gëzojemi pavarësisë në mënyrë të natyrshme, të festojmë në familje me miq, ta përjetojmë shpirtërisht, që kjo ditë të jetë një festë e shenjtë.

Ne, Aleanca Kosova e Re, përgëzojmë gjithë popullin e Kosovës pa dallim etnie, feje, race, për pavarësinë dhe fillimin e ndërtimit të shtetit më të ri në botë.

Pavarësia është e gjithë popullit të Kosovës

Kosova e pavarur tani është shumë më afër fqinjëve të saj, do të jetë një shtet i civilizuar, pa kufij kllasikë, do të garantojë barazinë e të gjithëve që jetojnë e do të jetojnë në Kosovë, atyre që e donë Kosovën, do të garantojë Lirinë e plotë të lëvizjes së njerëzve, ideve, mallrave dhe kapitalit.

Kosova do të jetë e integruar në rajon dhe shpejt do të jetë pjesë e Evropës Demokratike. Pavarësia i hap horizontin Kosovës për punë, zhvillim ekonomik dhe prosperim të gjithmbarshëm, për çka unë, qytetarë të nderuar, Ju bëj thirrje që të mobilizohemi për këto sfida.


Me fat të gjithëve!

Behgjet Pacolli,

Kryetar i Aleancës Kosova e Re

ËRFAQËSUESI I ZYRËS SË SHQIPËRISË NË KOSOVË VIZITOI AKR-në

Lideri i AKR-së, z. Behgjet Pacolli, duke e njoftuar në përgjithësi për aktivitetin e AKR-së që nga fillimi, shprehu gatishmërinë e tij dhe të subjektit që ai përfaqëson, për bashkëpunim të vazhdueshëm me zyrat ndërkombëtare, e veçanërisht për afërsinë dhe bashkëpunimin që duhet të ekzistojë në mes Zyrës së Shqipërisë dhe institucioneve të Kosovës...



Dje shefi i Zyrës së Shqipërisë në Kosovë, Arben Çejku, vizitoi Aleancën Kosova e Re, ku u prit nga lideri i kësaj partie, z. Behgjet Pacolli. Gjatë takimit z. Çejku uroi për suksesin dhe gatishmërinë që ka treguar AKR-ja gjatë kësaj periudhe, duke përgëzuar Behgjet Pacollin për arritjen në zgjedhjet e 17 nëntorit dhe për mbështetjen që kjo parti i ka dhënë procesit të pavarësisë së Kosovës. "AKR-ja ka treguar një rol shumë konstruktiv në këtë fazë të rëndësishme të proceseve në Kosovë dhe ky kontribut duhet të vlerësohet lart", -tha ndër të tjera shefi i Zyrës së Shqipërisë në Kosovë, z. Çejku. Lideri i AKR-së, z. Behgjet Pacolli, duke e njoftuar në përgjithësi për aktivitetin e AKR-së që nga fillimi, shprehu gatishmërinë e tij dhe të subjektit që ai përfaqëson, për bashkëpunim të vazhdueshëm me zyrat ndërkombëtare, e veçanërisht për afërsinë dhe bashkëpunimin që duhet të ekzistojë në mes Zyrës së Shqipërisë dhe institucioneve të Kosovës. "AKR-ja sot është partia kryesore opozitare dhe bart një përgjegjësi

të madhe ndaj popullit të Kosovës, prandaj ne do të jemi gjithmonë të gatshëm dhe aktivë në proceset e rëndësishme të Kosovës, duke bartur me dinjitet përgjegjësinë që na takon", -tha z. Pacolli. Z. Çejku shtoi se Kosova tashmë ka nevojë për rritjen e intensitetit rreth angazhimeve në procesin e integritetit dhe në këtë pikë ai tha se duhet të punohet me përkushtim edhe nga AKR-ja edhe nga Zyra Përfaqësuese e Shqipërisë në Kosovë. Z. Behgjet Pacolli falënderoi për vizitën z. Çejkun dhe i premtoi atij se bashkëpunimi do të jetë i vazhdueshëm dhe me një intensitet edhe më të shtuar, duke besuar fuqishëm se Kosova tashmë po realizon synimin e saj për shtet të pavarur dhe të integruar në bashkësinë ndërkombëtare. Shefi i Zyrës së Shqipërisë e përgëzoj z. Pacollin për revistën "Albani-ka", duke thënë se kjo revistë po pasuron në mënyrë të vazhdueshme bibliotekat tona dhe në të njëjtën kohë po i ofron lexuesit informacione të reja për kulturën shqiptare në përgjithësi. /B.S.

Aleanca Kosova e Re (AKR) ka përmbyllur aktivitetet për vitin 2007

Pacolli: AKR-ja s'do të ndalet, ky është vetëm fillimi

"Kemi plane madhështore për Kosovën. Do ta ndihmojmë implementimin e aspiratave tona shekullore të pavarësisë, interpretimin e drejtë të saj. Do të punojmë për një Kosovë me vizion properëndimor, për një Kosovë të integruar në rajon dhe një Kosovë që synon të jetë pjesë përbërëse në familjen e madhe evropiane", ka thënë lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli



parë se nuk kemi vend që të veprojmë. Për këtë jemi tërhequr por kjo nuk do të thotë se do të tërhiqemi nga skena politike", ka thënë Pacolli, duke shtuar se AKR-ja do të jetë e opozitës konstruktive që do të miratojë çdo vendim konstruktiv të qeverisë.

"Nëse qeveria nuk do të punojë për interesat e qytetarit, për qytetarin, për vizionin tonë politik që Kosova është pajtuar me të, ne do ta ngrehim zërin dhe do të jemi oponentët kryesorë të saj", ka shtuar lideri i AKR-së.

Pacolli ka shprehur bindjen se partia që ai drejton do të jetë edhe më e fuqishme në të ardhmen, do të riorganizohet dhe do të punojë më shumë për një të ardhme të ndritur, duke evituar gabimet eventuale gjatë kësaj kohe të funksionimit.

Duke përmendur angazhimet që do të bëhen në të ardhmen në ngritjen e kapaciteteve brenda partisë, Pacolli ka theksuar se janë të hapur dhe në partinë e tij kanë vend secili që e do Kosovën dhe jetën më të mirë për të gjithë qytetarët e saj.

"Kemi plane madhështore për Kosovën. Do ta ndihmojmë implementimin e aspiratave tona shekullore të pavarësisë, interpretimin e drejtë të saj, dhe do të punojmë për një Kosovë me vizion pro perëndimor, për një Kosovë të integruar në rajon dhe një Kosovë që synon të jetë pjesë përbërëse në familjen e madhe evropiane", ka thënë lideri i AKR-së. Jo në mënyrë të detajuar, por sipërfaqësisht është shpalosur edhe programi i AKR-së në sferën e investimeve të bëra në Kosovë duke përfshirë kështu investimet në sferën kulturore, shoqërore dhe infrastrukturale.

"AKR-ja në bashkëpunim me Fondacionin Behgjet Pacolli në dy vjetet e kaluara ka investuar mbi 32 milionë e 500 mijë euro, investime të cilat janë evidente dhe shkojnë në favor të ardhmërisë së Kosovës", ka thënë Pacolli.

Investimet e bëra nga lideri i AKR-së në Kosovë janë të shumta, por këto investime kanë qenë në rindërtimin e shtëpive, rrugëve, rrjete të ujësjellësve, ndërtimin e institucioneve arsimore universitare, pastaj ndihmesa të ndryshme në fushën e sportit, kulturës si dhe një investim i bërë në mbulimin e investimeve për 30 studentë që studiojnë jashtë dhe në vend.

**EPOKA
ERE** RABIE BALA

Prishtinë, 27 dhjetor - "AKR-ja ka një përvojë të vogël në skenën politike, por ne nuk do të ndalemi, do të rrugëtojmë dhe me praninë e 13 deputetëve në Parlamentin e Kosovës do të jemi pjesë të proceseve në të ardhmen", ka thënë kryetari i kësaj partie, Behgjet Pacolli, të enjten gjatë një takimi përmbyllës të AKR-së për vitin 2007.

Pacolli para shumë miqve, ndër të cilët ishin të pranishëm edhe shefi i UNMIK-ut Joachim Ruecker, përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovë, kryetari i LDD-së akademik Nexhat Daci, kryetari i PLK-së Gjergj Dedaj, përfaqësues nga Bashkësia Islame e Kosovës, përfaqësues të medieve dhe shumë personalitete të tjera nga jeta politike dhe shoqërore, ka folur për aktivitetet e kësaj partie.

"AKR-ja në tetor të vitit 2006 ka mbajtur Kuvendin themelues për më pak se një vit para zgjedhjeve të para dhe ka arritur të ndërtojë një strukturë të qëndrueshme organizative, politike, duke shtrirë aktivitetin e saj në mbi 400 degë e nëndegë në të gjithë territorin e Kosovës", ka thënë Pacolli.

Ai, po në këtë kontekst, ka shtuar

se, AKR-ja edhe pse është parti jashtë institucionale, shumë shpejt u bë pjesë e spektrit politik në Kosovë, me impetrimet e saj në mbështetje të procesit politik lidhur me statusin e vendit.

Pacolli ka përmendur gjithashtu se roli i AKR-së në këtë proces në

vazhdimësi ka qenë konstruktiv dhe se kjo parti ka ndërtuar vizionin e saj për Kosovën në raport me zhvillimet e çështjeve të rëndësishme në vend.

"Ndryshe nga partitë e tjera politike, AKR-ja hartoi një projekt që në fokus të veçantë kishte situatën


ekonomike të Kosovës", ka thënë Pacolli, duke shtuar se projektet e AKR-së mbështeten në dy shtylla kryesore, qeverisjen efektive dhe zhvillimin ekonomik që do ta përbënin thelbin e ndryshimeve të shumëpritura të gjendjes aktuale në Kosovë.

Pacolli ka përmendur edhe suksesin e arritur në zgjedhjet e 17 nëntorit, duke theksuar se si një parti e re ka arritur të jetë e treta në skenën politike të Kosovës.

"AKR-ja ka një përvojë të vogël në skenën politike, por ne nuk do të ndalemi, do të rrugëtojmë dhe me praninë e 13 deputetëve në Parlamentin e Kosovës do të jemi pjesë të proceseve në të ardhmen", ka thënë Pacolli.

Ai ka shtuar se AKR-ja ka qenë e hapur për të bashkëqeverisur po të kishte hapësirë për të, andaj është tërhequr nga koalicioni eventual qeverisës dhe do të qëndrojë në opozitë.

"Kemi qenë të hapur për qeverisje, por ne me kalimin e kohës kemi parë se AKR-ja nuk ka vend në Qeverinë e Kosovës në mandatin e ardhëm dhe me këtë konstelacion të qeverisë, horizonti ynë është i ngushtë dhe kryesia vendosi që ne të tërhiqemi nga koalicioni qeveritar, jo pse nuk respektojmë njërin apo tjetrën parti, por kemi



Lideri i AKR-së u takua me shefin e Zyrës Austriake

Punë dhe zhvillim ekonomik për shtet funksional

Prishtinë, 27 shkurt - Propozimi për zgjidhjen e statusit të Kosovës i kryenegociatorit Martti Ahtisaari Kosovës ia krijon bazën e shtetit, tha të martën lideri i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli. Sipas tij, me punë dhe zhvillim ekonomik do të ndërtohet shteti funksional.

Pacolli i ka bërë këto komente në një takim me shefin e Zyrës Austriake në Prishtinë, Alexander Bayerl.

Qëllimi i vizitës së diplomatit austriak në AKR, sipas zëdhënësit Kreshnik Sylejmani, ka qenë njohja me programin e partisë. "Jam i bindur që hyrja e Pacollit në politikë do ta ndihmojë Kosovën dhe do të sjellë kualitet në politikën kosovare. Është impresionues programi ekonomik i AKR-së", ka thënë Bayerl. Sipas tij, ekonomia do të jetë elementi kryesor për ndërtimin e Kosovës, pas zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Ndërkaq, Pacolli e ka falënderuar Austrinë për ndihmën që i ka dhënë dhe po i jep Kosovës.

"Pacolli ka kërkuar nga Bayerl që Austria të ndihmojë sa më shumë në reformimin e sistemit arsimor dhe shëndetësor në Kosovë, pasi dihet se Austria është vend strategjik për reforma në këto dy fusha", tha Sylejmani. (v. Idrizi)



Behgjet Pacolli dhe Alexander Bayerl

Liberaldemokratët e inkurajojnë AKR-në

Prishtinë, 27 shkurt - Zyrtarët e Liberaldemokratëve të Parlamentit Evropian (ELDR) i kanë inkurajuar udhëheqësit e AKR-së për ta avancuar programin liberal, në të cilin bazohen. Ibrahim Gashi, nënkryetar i AKR-së, tha se në takim me ta është diskutuar

për prioritetet e programit të AKR-së, aktivitetet, shtrirjen dhe orientimin politik të saj. "U përqendruam sidomos në programet dhe aktivitetet në fushën e ekonomisë dhe të drejtave të njeriut, në të cilat AKR-ja ofron alternativat më të mira në vend", tha Gashi.

Sipas tij, intensifikimi i raporteve dhe kontakteve me liberaldemokratët e Evropës është pikësynim i AKR-së. Annemie Neyts, presidente e liberalëve të Parlamentit Evropian, tha se qëllimi i vizitës së saj në Kosovë është të kontaktojë me liderët e ndryshëm dhe të bisedojë me ta për situatën këtu, për planin e Ahtisaarit etj. (d. z.)

Intervistë me kryetarin e Aleancës Kosova e Re

Behgjet Pacolli kërkon të rikomponohet Ekipi i Unitetit

Unë nuk jam për atë që atyre (Ekipit të Unitetit) t'u merret e drejta që të vazhdojnë bisedimet, mirëpo ai duhet të begatohet, të rigjionerohet, të bëhet edhe me njerëz të tjerë, me njerëz kompetentë, transparentë, ka thënë dje Behgjet Pacolli, sipas të cilit në këtë ekip do të duhet të përfshiheshin politikanë të para viteve të 90-ta. Përndryshe, Pacolli ende shpreson se Rusia nuk do ta përdorë veton në Rezolutën për Kosovën

Përpamim i sufi

Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka hedhur dje idenë se Ekipi i Unitetit, në 120 ditëshin e ardhshëm duhet të funksionojë në përberje të re. Në një intervistë për "Zërin", Pacolli ka akuzuar liderët kosovarë dhe negociatorët gjatë procesit të bisedimeve në Vjenë për triumfalizim të paqenë dhe për mustransparenca. Dëshmesim i ngjashëm me sili në Lugano të Zvicrës, tashmë ka instaluar në shtëpi e partise së tij lidhjen live në mënyrë që të mund t'i drejtoje takimet e kryesive në partise dhe të njohet për zhvillimet në parti edhe kur ai nuk është në Kosovë.

I ngjohur për lidhjet e tij afariste me Rusinë, Pacolli thotë se Kosova nuk është problemi kryesor në marrëdhëniet e Perëndimit me Rusinë, porësia "thosin asnjëherë deri më tani nuk ka bërë punë me vetë".

Përdërisa shtumicë e kohës e kalon në shtëpi e kompanisë së tij në Zvicër, Pacolli tashmë ka instaluar sistemin e videokonferencës në shtëpi e partise së tij në Prishtinë për të qenë i pranishëm në mbledhjet e kryesive.

Zëri: Z. Pacolli, si e komentoni zgjedhjen e procesit për zgjidhjen e statusit të Kosovës?

Pacolli: Nëse i shikoni intervistat që i kam dhënë në tetorin e vitit të kaluar, kështu thotë se për statusin do të flitet vetëm pas 7 korrikut. Politikanët të Kosovës nuk i kanë dalë datat që kanë dhënë. Unë mbrohem me keqardhje djigjova se Kullit ka vendosur që të bisedohet edhe më tej me Serbinë dhe në këtë rast në këtu do të kemi status kus. Parlamentit Kosovës duhet të shpërtojë konstelacionin e Ekipit të Unitetit, duhet të vlerësojë transparenca e tyre, punën e tyre dhe gjilshetë ky grup duhet të kontrollon. Ky grup nuk mundet me të tregojë gjënjehura e të përmendë "sor, rusia...". Ai është një organ që është zgjedhur nga ish- Presidentin Ibrahim Rugovë, është konfirmuar nga Parlamenti dhe ai tani duhet të rikonsolidohet.

Zëri: Në çfarë mënyre mendoni...?

Pacolli: Unë nuk jam për atë që atyre (Ekipit të Unitetit) t'u merret e drejta që të vazhdojnë bisedimet, mirëpo ai duhet të begatohet, të rigjionerohet, të bëhet edhe me njerëz të tjerë, me njerëz kompetentë, transparentë, ka thënë dje Behgjet Pacolli, sipas të cilit në këtë ekip do të duhet të përfshiheshin politikanë të para viteve të 90-ta. Përndryshe, Pacolli ende shpreson se Rusia nuk do ta përdorë veton në Rezolutën për Kosovën

Jenerahet, të bëhet edhe me njerëz të tjerë, me njerëz kompetentë, transparentë. Populli është lodhur duke pritur.

Zëri: A kërkon një vend ju personalisht në Ekipin e Unitetit?

Pacolli: Unë nuk jam pjesë përberëse e Ekipit të Unitetit, as e qeverisë, as e parlamentit. Unë nuk insistoj, mirëpo në kemi shumë njerëz me eksperiencë të cilët jetojnë në Kosovë dhe ata mund të përfshihen. Nuk është me rëndësi sa persona do të përfshihen, a du të jenë 10 apo 15, mirëpo me duhet t'i tregojmë popullit transparenca dhe duhet të thuhet se nëse do të kemi 120 ditë tjera bisedime, për çka do të bisedohet dhe çka do të ndodhë pas këtyre 120 ditëve. Është e pamundur që t'u premtohet njerëzve, sepse ata janë të lodhur, janë nervozë dhe mund të provokohen dhe të krijojnë probleme që mund të kenë pasojë.

Zëri: Cili emër mund t'i shtohet këtij grupi?

Në Grupin e Unitetit të hyjnë politikanët e para viteve të 90-ta

Pacolli: Do të kthehesha të veteraneve. Ata që kanë qenë të involvuar në politikën e ish-Jugosllavisë, bile para viteve të '90-ta. Unë kam një mik që është kryetar i një prej shteteve të ish-Jugosllavisë që me dinjëtit kryen funksionin e vet e që thotë vazhdimisht se problemi i Kosovës nuk është problem që lind me luftën në Kosovë, por është një proces shumë i gjatë që fillon ashtu me Kushtetutën e vitit 1974, kur Kosova ka qenë pjesë përberëse e ish-federatës jugosllave, e barabartë me shtetet tjera në çdo pikëpamje deri sa Serbia e morri autonominë në fund të viteve '90. Aty qëndron problemi. Kosovës duhet t'i jepet atë legjitimitet dhe të ndahet sikurse janë ndare republikat tjera. Këtë më se miri do ta kishin bërë politikanët veterane, e jo njerëz që tani flasin në dimensione shumë të shkurtra.

Zëri: Si e vlerësoni punën e deritashme të Ekipit të Unitetit?

Pacolli: Për dhe konira. Për është se ato kanë punuar, kontra sepse ata aspak nuk kanë qenë të sigurtë, nuk kanë qenë transparentë me popullin. Ata janë duke punuar për popullin.



"Është mirë që Serbië t'i thuhet se Kosova do të jetë aleat që do të vazhdojë të punojë me Serbinë, nuk do të ketë mur ndarës mes Kosovës dhe Serbisë, mirëpo do të jenë dy aleatë më të drejtë të barabarta ndërkombëtare. Duhet të bisedohet dhe, nëse ka nevojë edhe të shohet në Beograd, ose ata të vijmë në Prishtinë drejtpërdrejtë. Të bisedohet bile edhe pa përkthyes". Behgjet Pacolli, kryetar i AKR-së

Këshillin e Sigurimit. Në problem që e ka sot Perëndimi me Rusinë, nuk është Kosova problemi kryesor. Kosova është një prej problemeve shumë të vogla që mund zgjidhet në globalitet, duke i zgjidhur problemet tjera. Ekziston problemi i shtrirjes së NATO-s në territorin e ish-Bashkimit Sovjetik, demokratizimi apo politika pro-perëndimore e Gjyrgjisë dhe Ukrainës. Këto janë problemet kryesorë. Kosova nuk paraqet një vend strategjik, por se Serbia. Nuk janë problemet që mund mund të zgjidhen. Janë probleme me grup, në të cilin zgjidhet diku edhe Kosova.

Në shtyrjen e votimit të rezolutës unë nuk e bëj faktor Ekipin e Unitetit as vullndëzues të Kosovës. Ajo ka qenë e evidente dhe kjo është dashur t'i tregohet popullit. Nuk mundet që institucionin në lartë të Kosovës t'i drejtohet kosovarëve, mos t'i largoni prej vendit se do ta krenojmë përjavërisht, e të nesërmen të thuhet se është shtyrë rezoluta. Kjo është përgjegjësi shumë e madhe dhe kjo përgjegjësi tani reflektohet në të gjitha lëshat operuese të qeverisë së Kosovës, edhe në ekonominë, por edhe në seriozitetin e obligimeve që qeveria duhet t'i kryejë.

Zëri: Nëse nesër do të dilte për votim në Këshillin e Sigurimit rezoluta për Kosovën, a priti veton ruse?

"Me Beogradin është mirë të bisedohet drejtpërdrejt, bile edhe pa përkthyes"

Pacolli: Unë prapë po e pëzëris atë që e kam thënë gjithmonë: Rusia asnjëherë nuk ka thënë se do ta përdori veton. Këtë e ka thënë edhe ambasadori rus të Beograd para pak ditëve, por edhe ministri i jashtëm Lavrov. Kjo është një gjë e trilluar, mirëpo, ata me fuqinë e tyre po mundohen të shtyjnë negociatat gjë që do t'u konvenonte momentalisht, vetëm momentalisht, konsolidimi të qeverisë serbe. Asgjë tjetër. Por është dashur t'i thuhet në sy qeveritarëve të Beogradit: Kosova asnjëherë nuk do të jetë me nën Serbi, ka marrë fund një punë. Ata e dinë këtë më mirë se ne në Kosovë. Sot çdokush e din në Serbi se Kosova nuk i nevojitet më Serbisë. Ata e dinë se është krerë problemi i Kosovës. Është mirë që Serbië t'i thuhet se Kosova do të jetë

aleat që do të vazhdojë të punojë me Serbinë, nuk do të ketë mur ndarës mes Kosovës dhe Serbisë, mirëpo do të jenë dy aleatë me të drejta të barabarta ndërkombëtare. Duhet të bisedohet dhe, nëse ka nevojë edhe të shohet në Beograd, ose ata të vijmë në Prishtinë drejtpërdrejtë. Të bisedohet bile edhe pa përkthyes...?

Zëri: Edhe pa ndërkthyes...?

Pacolli: Ndërkthyesit gjithmonë do të jenë aty. Mirëpo duhet të bisedohet me njerëz të drejtëpërdrejtë dhe t'u thuhet se është në Kosovë është e kryer dhe tani mund të bashkëpunojmë në tëshen kulturorë, artimorë, të shëndetësorë apo të ekonomitë. E dinë se nënosta do të jetë shumë e lehtë, por të jepet edhe ky shans. Për mua personalisht nuk është katastrofë e madhe nëse shtetë rezultu për 120 ditë, mirëpo në duhet të shikohet në të përcaktim dhe t'ndim çdo ditë çka po ndodh në ato bisedime.

Zëri: Çka mendoni se duhet të bëhet gjatë Gjeorgjisë 120 ditëve?

Pacolli: Është besoj se duhet të punohet për zgjidhjet dhe për këto 120 ditëve edhe parlamentet duhet të punojnë me intensitet shumë të lartë. Po të voto përjavërisht këto ditë, në kjo kjo është shumë të papërgatitur. Në nuk kemi as simbole, është abstrakte që një grup qeverisës e hapin konkursin për simbolet e Kosovës, sikur të jenë ato një vepër artitshtrë. Kjo gjë duhet të bëhet në parlament dhe parlamentin ka qenë dashur ta zgjedhë një grup për ta hapur konkursin. Të merrtet Ekipi i Unitetit me këto gjera është një abstrakt që mund të ndodh vetem në Kosovë dhe askund tjetër në botë. Në ende nuk e dimë me cilin flamur do të festohet pavarësia. Ky është një dënim i madh. Pas 120 ditëve në duhet t'i kemi të gjitha të gatshme. Kushtetutën, flamurin, simbolet tjetër.

Zëri: A jetë duke vazhduar lobimin për pavarësinë?

Pacolli: Unë që nga tetori i vitit 2005 në vazhdimësi jam duke vazhduar lobimin dhe rezultatet e këtij lobimi në SHBA kanë qenë evidente. M'fatigën që kam jam duke punuar në Washington që dy vjet dhe të mëson gjë jam duke e bërë që me shprehori i vij të kaluar në Rusi.

Zëri: Cilat janë rezultatet e lobimit në Rusi?

Pacolli: Unë besoj që gjithmonë duhet thënë se janë pozitive. Nëse idëja e Presidentit të Francës, Sarkozy ka qenë kompromisi i fundit politik me Rusinë. Asaj i jepet ky status, me dulet të presim, mirëpo tani në duhet të shikojmë me mënyrë që çka dë duhet të raportojmë në mënyrë transparente dhe të sigurtë.

Zëri: Jemi optimistë se Putin në fund do të pranojë propozimin e Presidentit të Francës?

Pacolli: Ajo nuk është 100 e tij (Presidentit Sarkozy). Është konkluzioni i tyre marrëveshjeje e cila nuk është shprehur tani.

Kryeministri i Kosovës mbajti takimin e rregullt me shefin e UNMIK-ut Çeku dhe Ryker bisedojnë për transicionin

Çeku dhe Ryker kanë vlerësuar se institucionet e Kosovës dhe UNMIK-u janë të përkushtuara për të çuar përpara të gjitha çështjet konkrete që përfshihen në procesin e transicionit

Kryeministri Agim Çeku dhe kryesudatistrotori Joakim Ryker në takimin e djeshëm kanë diskutuar për procesin e transicionit të zgjidhjes së statusit të Kosovës dhe për zhvillimet e përgjithshme aktuale në Kosovë.



Çeku dhe Ryker, pas takimit të rregullt javor, nuk kanë futur para qendrës, kështu që tani duhet më për të kishin bërë diskutime për ta përcaktuar, ndërkohë që në komunikimale e lëshuar nga Zëri e Kryeministrit thotë se ata kanë vlerësuar se institucionet e Kosovës dhe UNMIK-u janë të përkushtuara

Kreu i Ora-s po merr pjesë në një tryezë për marrëdhënie ndëretnike në Athinë Surroi i kërkon Perëndimit që t'i kapërcejë kërcënimet ruse

"Nëse vazhdon ky zhvillim politik, atëherë vija ndarëse mes Rusisë dhe Perëndimit do të kalojë mes përmes qytetit të ndarë të Mitrovicës, gjë e cila do të jetë me republikacione negative edhe në zhvillimin e demokracisë në Kosovë, por edhe në Serbi", ka thënë dje në Athinë, Veton Surroi

Kryetari i Partisë Reformiste Ora dhe kryetar i Komitetit të Ekspertëve të Unitetit, Veton Surroi ka akuzuar nga faktori ndërkombëtar që të mos lëshojë për ndaj kërcënimet ruse për statusin e Kosovës, pasi kjo gjë do të dëmtojë funksionalitetin e zgjidhjes për Kosovën. "Qëndrimi paqenë i Rusisë si dhe insistimi për një përfundim të ri, duket kryerë zgjidhje të cilat janë të komplikuar, e bën Kosovën dhe Perëndimin peng të bëjnë kërcënimet dhe kjo përfundim se dëmton shumë funksionalitetin e zgjidhjes për shkak të ardhshëm të

Kosovës", ka deklaruar Surroi të premtim në Athinë, gjatë një tryeze me temën "Ballkani burim i sigurisë dhe stabilitetit në Evropë" organizuar në kuadër të projektit të marrëdhënjëve ndëretnike. Në këtë tryezë, Surroi ndër të tjera ka paralajmëruar ndërkombehtarë të rrezikun se në zhvillimet e tilla politike, Kosova do të shprehohet në vijë ndarëse të një lufte të re të fituar me mes Rusisë dhe Perëndimit. "Nëse vazhdon ky zhvillim politik, atëherë vija ndarëse mes Rusisë dhe Perëndimit do të kalojë mes përmes

qytetit të ndarë të Mitrovicës, që e cila do të jetë me republikacione negative edhe në zhvillimin e demokracisë në Kosovë, por edhe në Serbi", thotë në një komunikimale të lëshuar nga ORA, të jetë thënë dje në Athinë, Veton Surroi.

PSE BEHGJET PACOLLI PAS VEPRAVE TË MËDHA, KA VENDOSUR TË KTHEHET NË VENDLINDJEN E VET?

PASTHËNIE NGA EDI RAMA¹

Të them të drejtën, erdha me gëzim, se thashë, të paktën një herë do dëgjoj dhe nuk do të flas. Por, nga ana tjetër, mendoj që është privilegj, të them dy fjalë për këtë rast që na ka mbledhur së bashku, duke e nisur nga proverbi që solli Behgjeti këtu se ‘Nuk ka Profet në Fshatin e vet’ dhe duke shkuar më tutje, me çka unë kam menduar gjithmonë, por më intensivisht përpara disa ditësh, kur ishim me Behgjetin në Kazakistan e ku pata mundësinë të vizitoj disa nga veprat e tij të mëdha e të takoj disa nga mijëra shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës që punojnë në kantieret mbresëlënëse të Astanës, një kryeqytet i ngritur nga e para qysh prej vitit 2000.

Ajo çka kam mendur e dua të them është: ç’ e shtyn këtë njeri, që siç e tha dhe vetë, është në kulmin e një suksesi të ëndërruar fort dhe për të cilin ka luftuar gjithë këtë pjesë të jetës, si sipërmarrës që ka ngritur një ndërmarje globale e cila punon me 30 monedha të ndryshme e në të cilën fliten 40 gjuhë, që të kthehet andej nga u nis, në fshatin e vet e të marrë përsipër t’i hyjë detit në këmbë duke u marrë me politikë në një pjesë të trojeve shqiptare. E theksoj këtë “Duke u marrë me politikë shqiptare”, që është një lloj ushtrimi shumë i veçantë për ata që merren me politikë në përgjithësi.

Sigurisht që është një rast unikal sa i përket asaj që përbën diferencën jonormale midis një jete jashtë fshatit dhe një jete brenda tij. Besoj që përgjigjen, në një farë mënyre, mund të na e japë ajo çka Salvador Dali u tha akademikëve të Francës kur i dhanë titullin e madh të Anëtarit të Akademisë, me një pompozitet të jashtëzakonshëm: “As ky titull nuk ma shëron kuriozitetin për sa më duan në fshatin tim”. Dhe kjo është arsyeja kur njeriu e di që s’ka profet në fshatin e vet, prapë së prapë, sado larg e lart të shkojë e sado i suksesshëm të jetë, në fund të rrugës ka gjithmonë këtë kuriozitet të pashërueshëm: “Sa e duan në fshatin e vet” Dhe Behgjeti është kthyer në fshatin e tij për të dhënë, jo për të marrë. Por edhe për të marrë diçka që njerëzit në jetën e përditshme të kësaj bote të konsumit rëndom e harrojnë dashurinë e fshatit të tyre.

¹ Fjala në ceremoninë e nderimit tim me çmimin special të LiderShipit nga fondacioni CoPlan dhe Universiteti Polis, në 30 maj 2014. E zgjedha ta përfshij këtë tekst në librin tim, pse ai ka kapur thelbin e veprimit dhe ndjeshmërisë time sociale dhe politike: pse unë jam kthyer t’i shërbej Kosovës.



Gjatë ceremonisë për marrjen e çmimit special të Leadershipit

Behgjet, nuk e di nëse precedenti që unë e mora këtë titull kur isha kryetar bashkie, e sot jam kryeministër, do vlejë dhe për ty pas ca vitesh. Sot e merr si zëvendëskryeministër, por jam i bindur që, çfarëdo titulli që ti të marrësh, asgjë nuk do të ta shërojë deri në fund të jetës kuriozitetin tënd se sa do të të duan, deri në fund, në fshatin tënd. Politika është një rrugë për ta testuar këtë dashuri, por kam frikë se është një rrugë qorre, që nuk ta jep përgjigjen. Ajo që do të mbetet në fund, është vepra e secilit dhe besoj se tanimë Behgjet Pacolli e ka lënë veprën e vet. Dhe nderi që i bën Universiteti apo Co-PLANi-se e njëjta gjë është-siç do të thoshte dikush-duke i dhënë këtë çmim është se hapur i jep të gjithëve mundësinë, të shikojnë atë që Behgjeti, fatkeqësisht, thujse gjithmonë, ia ka fshehur si me një kompleks faji fshatit të vet, se sa i madh është dhe se çfare suksesi ka arritur të bëjë në një botë jashtëzakonisht të ngatërruar dhe të vështirë me 40 gjuhë. Kjo është hera e parë që flitet për Behgjet Pacollin, jo vetëm si një milioner i radhës i ngarkuar me hijet e dyshimta të së shkuarës që vjen për të zhvatur nëpërmjet politikës komunitetin e vet, por si një njeri që zbret nga një majë shumë e lartë suksesi në fshatin e vet, për t'i dhënë atij pak nga suksesi i tij.

Unë jam shumë i privilegjuar që jam ndër miqtë e Behgjet Pacollit. E kam ndier këtë qysh ditën e parë që e kam njohur, pasi kam njohur veprën e tij. Sot ky është një titull më shumë, dhe asgjë më tepër sesa një titull më shumë, por përtej gjithë titujve, Behgjet Pacolli ka vlerën e të mospyeturit për faktin se nuk ka profet në fshatin e vet. Kurajo paç, e jetofsh deri në fund me këtë trimëri, që pavarësisht se s'ta njeh kush atë që bën, ta bësh deri në fund.

NJË GUR KILOMETRIK THEMELTAR NË HISTORINË E DIPLOMACISË SË SHTETIT TË RI TË KOSOVËS

NGA PROF.DR. AFRIM HOTI

Libri i ri, vëllimi i parë i « *Të Lobosh për Kosovën – Pavarësia dhe SHBA-të* », i zotit Behgjet Pacolli është libri më i parë dhe më autentik i diplomacisë së re të shtetit të Kosovës në betejat për integrimin. Kur nesër të shkruhet historia e Kosovës, shtetit më të ri në Europë, kur të hiqen pengesat e rënda 25 vjeçare të arkivave, historia e diplomacisë së Pacollit do të zerë një vend të veçantë. Ky libër është një gur kilometrik themelor në të dy historitë, në të Kosovës dhe gjegjësisht në atë të diplomacisë duke zbuluar vetëm një pjesë kyçe të kësaj diplomacie projektuar kah SHBA-së, në një moment të veçantë të shtetlindjes sonë.

Ky libër është libër i një miku të madh të Amerikës siç duket nga nderimet e shumta të tij në SHBA, nga miqtë e rëndësishëm, nga veprat e mëdha me bashkautorë figura të shquara të diplomacisë amerikane dhe sot.

Pse i bëj këto pohime?

Mbështetem pikësepari në kontekstin e ngjarjeve të asaj periudhe. SHBA-të, fuqia vendimmarrëse kryesore e botës, kishte rol thelbësor në çlirimin e Kosovës me udhëheqësinë e Presidentit Clinton. Por ngjarjet e vitit 2001, ndërrimet e administratave presidenciale, prioritete të reja në skakierën globale të fuqive e shmangën sadopak dosjen e Kosovës nga axhenda e prioriteteve kryesore të politikës amerikane. Edhe ngjarje të brendshme të Kosovës, me siguri të orkestruara nga vetë Serbia siç ishin episodet e dhunshme të vitit 2004, ndikuan për të nxitur një fushatë të egër të lobit serb në SHBA dhe në botë për të cënuar imazhin e Kosovës. Tashmë, në krye të Serbisë kishin ardhur faktorë të rinj, të cilët bënë sikur nuk ishin vazhdues të veprës së Milosheviqit, ndaj ata kishin njëfarë aftësie depërtuese në kancelaritë perëndimore. Këto përfundime nuk i nxjerr unë. Janë përfundime publike të disa protagonistëve të rëndësishëm të diplomacisë amerikane për Kosovën mes të cilëve ambasadori legjendar Richard Holbruk, sipas të cilit pavarësia e Kosovës do duhej të shpallej shumë më herët që në 1999. E pohojnë dhe personalitete të shquara si zëvendëspresidenti aktual Joseph Biden, asokohe senator mjaft i angazhuar në kauzën shqiptare, siç del dhe nga ky libër. Këto pohime janë veçanërisht të rëndësishme pse sot brezi i ri e konsideron pavarësinë e Kosovës si fakt të kryer me çlirimin e saj në 1999.

Pikërisht në këtë kontekst që shpjegova më sipër del në skenë Behgjet Pacolli me veprën e tij lobuese të cilën e rrëfen qartësisht dhe thjesht në pjesën e parë të librit-« pse unë lobova për Kosovën në SHBA ». Libri nuk është libër dukjesh, fotografish, shfaqjesh në krah të tij apo të tjetrit politikan të SHBA-ve siç bëjnë rëndom shumë politikanë të vendit tonë apo të rajonit. Behgjet Pacolli si zakonisht ka ruajtur modestinë e vet, modesti karakteriale për të cilën Flet me shumë simpati Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë në pasthënien e librit. Libri i zotit Pacolli është libër i diplomacisë alternative që sot në SHBA është mjaft efektive. Ai, siç tregohet nga korrespondenca, emaillet, artikujt, organizimet e konferencave, kontaktoi një kompani mjaft efektive lobimi, e cila nëpërmjet ish-diplomatëve të klasit të parë, ish-sekretarë mbrojtjeje, ish-ambasadore në shtete të mëdha, lidhjeve me familjen Clinton, ndikoi në formulimin e një fushate rezultative pro pavarësisë së Kosovës. Rreziqet ishin të mëdha dhe në libër tregohen përplasjet dramatike me lobin serb të vënë në lëvizje nëpërmjet Kishës dhe shtetit serb i cili investoi shumë para për

të ndalur rrotën e historisë që po shkallmonte padrejtësinë e madhe historike ndaj shqiptarëve. Ky lob i drejtuar prej ish-gubernatorit të Illinoisit, Rod Blagojeviç i cili përfundoi në burg për korrupsion, mund të kishte bërë dëme të mëdha në shtyrjen akoma të zgjidhjes së kësaj çështjeje nëse nuk do të ishte përballur me ndërmarrjen gjigante lobuese të organizuar nga zoti Pacolli.

Në këtë libër flitet për punë të mëdha dhe të kryera: SHBA vendosi përfundimisht në favor të pavarësisë së plotë të Kosovës. Artikujt, konferencat, mbledhjet në Kongres, qasja krijuese e ndërlidhjes së pavarësisë me hapësirën rajonale ekonomike, janë punë të jashtëzakonshme mbrapa të cilave qëndron Behgjet Pacolli. Këto janë vepra të nxitura prej tij, të mbështetura prej tij, të financuara prej kompanisë së tij. Me diplomacinë e vet jokonvencionale Behgjet Pacolli arriti një sukses i cili do të kujtohet pashlyeshëm në historinë e shtetit të ri të Kosovës. Kjo diplomaci jokonvencionale funksionoi dhe po funksionon dhe për sigurimin e njohjeve të shtetësisë së Kosovës kudo në botë, nëpërmjet prodhimit të interesave ekonomike të përbashkëta. Ky mbase do të jetë objekti i një libri të ri për diplomacinë lobuese që Pacolli ka thënë diku me krenari të matur se do të studiohet nëpër universitetet e botës.

TË LOBOSH PËR KOSOVËN

Pavarësia dhe SHBA-të

Por pa dyshim momenti më kulmor i lobimit tonë ishte futja e frazës “KOSOVA DUHET TË JETË NJË SHTET I PAVARUR, TANI”, në fjalimet e Bushit gjatë vizitës në Shqipëri në qershor të vitit 2007. Ishte praktikisht kurorëzimi i punës sonë të madhe me miqtë që përmenda dhe miqtë e miqve. Si punuam për këtë objektiv? Kur u vendos që Bush të vizitonte Shqipërinë, unë dhe miqtë e mi patëm rastin që me njerëzit më të afërt të presidentit të njihnim dhe diskutonim për axhendën që po diskutohej dhe me ambasadën shqiptare në telefon. Mbaj mend se punuam shumë, u desh shumë kohë që ajo fjalë të vendosej në gojën e tij deri në orën 4 të mëngjezit, në bashkëpunim me një mik tonin që punonte në Administratën e lartë të Presidentit Bush, dhe që vinte prej Zvicrës dikur.

Unë e kam ditur, pra dhe nuk e kam thënë kurrë më parë se Bush do të përmendte fjalën magjike - PAVARËSIA, dhe se kjo ishte fryt i lobimit tonë. Ardhja e tij në Shqipëri, pritja madhështore që iu rezervua, ia nxori këtë fjalë jo vetëm nga mendja, por dhe nga shpirti. Unë pata rastin që ta falënderoja personalisht Presidentin Bush për këtë nder të madh që i bëri Kosovës. Më 4-5 prill të vitit 2008, ai vizitoi Zagrebin dhe miku im, Presidenti Mesiç më ftoi që të merrja pjesë në disa prej aktiviteteve të tij. Kështu arrita ta takoja në hotelin ku ai rrinte dhe t'i dhuroja një pikturë që riprodhonte një foto familjare të Bushit, me gruan dhe vajzat. Ishte një pikturë e jashtëzakonshme e autorit nga Shqipëria, të famshmit Zef Shoshi, e cila e la pa fjalë Presidentin Bush. I thashë se "ju keni bërë shumë për Kosovën, ju jeni i pari që keni folur për këtë pavarësi dhe unë dua t'ju lë këtë pikturë si kujtim!" Zoti Bush më tha se "kishte marrë shumë dhurata, por kjo sigurisht ishte diçka e paharruar që do ta marr me vete në shtëpinë time." Dhurata ishte zgjedhur në mënyrë të tillë që Presidenti Bush të mos e harronte Kosovën- një portret familjar, që ai mund ta çonte në shtëpinë e vet, ku do ta sodiste më shpesh se një dhuratë tjetër tipike.

Me këtë fjalë të Bushit në Shqipëri, me vizitën e suksesshme në vendin amë, me pritjen që iu rezervua, lobimit iu hap një horizont i ri.